

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5394
E hënë, 5 shkurt 2018
çmimi 0.40 €

Reshjet e shiut shkaktojnë
dëme të mëdha
në disa komuna ■ FAQE 10



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



FLET PËR "EPOKËN E RE" ZËVENDËSMINISTRI I
FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS, BURIM RAMADANI

Transformimi në Forca të Armatosura, proces i pakthyesëm

■ FAQE 4-5

Zëvendësimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Burim Ramadani, ka bërë me dije se transformimi i FSK-së në Forca të Armatosura është proces i pakthyesëm dhe i sigurt. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se ky

proces garanton sigurinë e të gjithë qytetarëve të Kosovës, të të gjitha komuniteteve, si dhe kontribuon në sigurinë rajonale. Ramadani ka mohuar çdo mundësi që çështja e formimit të ushtrisë të bëhet pjesë e procesit të dialogut

Kosovë - Serbi në Bruksel. Sipas tij, ky proces është në rrugën e mirë dhe nuk ndërthret me asnjë proces tjetër. Ramadani ka folur edhe për qeverisjen Haradinaj. Ai ka thënë se kjo Qeveri është më dinamika që ka pasur ndonjëherë Kosova

AKTUALE

RESPEKT NDAJ
HERONJVE TË
CILËT SHTRINË
DORËN E PAJTIMIT

F.13



Ragip SHALA

DEMARKACIONI:
EDHE UJKU I
NGOPUR, EDHE
TUFA E DHENVE E
PAPREKUR? F.11



Islam LAUKA

PRESIDENTI THAÇI PINË KAFE
ME DY KRYETARËT E DY
KOMUNAVE TË DRENICËS F.7

PËRMIRËSOHET NIVELI I AJRIT
NË KRYEQYTET F.7

EKONOMI

KURTI: RAPORTI
IMPORT-EKSPORT, 1 ME 10 F.9

ATK-JA NË VITIN 2017 KA
MBYLLUR 214 LOJËRA
TË FATIT F.9

SPORT

FETAHAJ: KOHA QË PRISHTINA
TË SHPALLET KAMPIONE F.18

KRASNOI TRIUMFON NDAJ
GRAFKAS F.18

Vetëvendosja nuk e voton demarkacionin, kërkon hetim nga prokuroria ■ FAQE 3

Deputetët e Lëvizjes
Vetëvendosje, Ali Lajçi dhe
Arbërie Nagavci, kanë kundërshtuar
procedimin e demarkacionit në

seancë plenare të Kuvendit të
Kosovës. Ata kanë thënë se jo
marrëveshje duhet të dërgohet
për hetim në prokurori



Neglizhencat politike dhe interesat biznesore pamundësuan kyçjen e Kosovës në TAP ■ FAQE 8-9

Njohësit e çështjeve ekonomike,
Safet Gërxhaliu dhe Blerim Grainca,
kanë thënë për gazetën "Epoka e re"
se rëndësia ekonomike, integruarë,
sociale dhe strategjike e kyçjes së
Kosovës në gazsjellësin Trans-

Adriatik (TAP) nuk është marrë
seriozisht nga institucionet e
Kosovës. Ata kanë theksuar se në
këtë proces ka dominuar agenda
politike dhe ndikimet biznesore të
importuesve të gazit në Kosovë

RENOVA
Mazgimi
Xhegjuajt-Telavë
Gatëz-Perizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROLKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Produkt e EPS nga XPS
Mob: +377(0) 44 506 815
Tel/Fax: +381(0) 29 246 030
E-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERLANKEN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Peshko Vasa", n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Reagimet kundër Ligjit për shqipen dëshmojnë ndarjet e thella etnike

Përveç nga partia opozitare, reagime kundër Ligjit për gjuhët ka pasur në vazhdimësi edhe nga qarqe të ndryshme, si intelektualë maqedonas, shoqata joqeveritare, si dhe në rrjetet sociale nga qytetarë të shumtë



Shkup, 4 shkurt - Partitë politike në pushtet ende pa zgjidhje lidhur me 35 mijë amendamentet e VMRO-së opozitare kundër propozim-ligjit për përdorimin e gjuhëve të bashkësive etnike, me të cilin pritet avancimi i përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe.

Përgjigjja e vetme që vjen nga institucioni ligjvënës është se shërbimet ende janë duke përkthyer amendamentet, që u parashtruan pas refuzimit të presidentit të shtetit Gjorge Ivanov, për dekretimin e ligjit që ishte miratuar muajin e kaluar.

Nga VMRO-ja kanë thënë se amendamentet e tyre bazohen në vërejtjet e presidentit, por në opinionin e gjerë veprimi i tillë i partisë opozitare, që drejtohet nga Hristijan Mickovski, interpretohet si vazhdimësi e politikës së ish-kreut të kësaj partie, Nikolla Gruevski.

Përveç nga partia opozitare, reagime kundër Ligjit për gjuhët ka pasur në vazhdimësi edhe nga qarqe të ndryshme, si intelektualë maqedonas, shoqata joqeveritare, si dhe në rrjetet sociale nga qytetarë të shumtë.

Vllado Dimovski nga Qendra për Tolerancë Ndëretnike ka thënë se propozimi nuk cenon Kushtetutën, siç pretendon opozita, ndërsa për gjendjen e krijuar fajëson edhe partitë në pushtet që, sipas tij, nuk kanë bërë sa duhet për ta bindur opinionin se ligji nuk rrezikon bashkësitë e tjera etnike, para së gjithash maqedonasit. "Propozim-ligjin për gjuhën po e interpretojnë secili në mënyrën e vet, pavarësisht se partnerët qeveritarë janë pajtuar për zgjidhjen që është në proce-

durë, por ata nuk po mund t'ua prezantojnë qytetarëve në atë mënyrë që edhe ata ta pranojnë. Unë thellë jam i bindur se ligji nuk prek Kushtetutën apo nuk është kundërkushtetues, por këtë nuk po e kuptojnë të gjithë, andaj edhe kjo ka shkaktuar reagime të ndryshme", ka thënë Dimovski.

Reagimet, ka shtuar ai, po dëshmojnë se shoqëria në vend ende është e ndarë në baza etnike. Mirëpo, siç ka thënë Dimovski, Maqedonia është shtet shumetnik dhe se këtë duhet ta kuptojnë të gjithë. "E ne ende nuk ka pjekuri të qytetarët e, para së gjithash, nuk ka pjekuri të politikanët, të cilët ende nuk e kanë të qartë se ne jemi shtet shumetnik dhe vetëm si i tillë mund të kemi prosperitet. Po ndihet një ndasi e madhe, duke filluar nga arsimit, kemi paralele të ndarë, fëmijë të ndarë në baza etnike, njohja e njëri-tjetrit apo mësimi i gjuhëve të njëri-tjetrit nuk është ende në nivelin e kënaqshëm. Duhet shumë punë për të bërë që të mos thellohen ndasitë. Mendoj se ka ardhur koha që të gjithë ne ta kemi të qartë se bashkësitë etnike në Maqedoni nuk duhet të jetojnë pranë njëri-tjetrit, por njëri me tjetrin", ka deklaruar Dimovski.

Ndërsa Arsim Sinani, njohës i çështjeve politike dhe drejtues i Qendrës për Studime Ndërkombëtare dhe Hulumtime Ballkanike, ka thënë se kjo që po ndodh në Maqedoni lidhur me gjuhën shqipe është e papranueshme dhe se LSDM-ja duhet të bëjë shumë më tepër për të dëshmuar se nuk është e koordinuar me VMRO-në. Në të


kundërtën, sipas tij, do të jetë e pashmangshme kërkesa për një marrëveshje maqedonase-shqiptare për ta përcaktuar të ardhmen e vendit. "Pala maqedonase dëshiron t'ua kufizojë shqiptarëve të drejtën natyrore të përdorimit të gjuhës shqipe. Mendoj se këtu ka një marrëveshje mes dy partive politike maqedonase, VMRO-së dhe LSDM-së, andaj edhe inkurajoj kryeministrin Zoran Zaev t'i vazhdojë reformat, por jo me njerëz të inkriminuar. Nëse ne dëshirojmë që Maqedonia t'i afrohet Bashkimit Evropian, NATO-s dhe të jetë një shoqëri pa probleme, do të duhet të ketë një marrëveshje në mes të maqedonasve dhe shqiptarëve që njëherë e përgjithmonë të zgjidhen problemet", ka deklaruar Sinani. Sipas tij, nga mbyllja e çështjes së përdorimit të gjuhës shqipe maqedonasit nuk humbin asgjë, përkundrazi kjo do t'i forconte raportet ndërmjet dy komuniteteve. "Gjuha shqipe e stabilizon Maqedoninë. Gjuha shqipe i përmirëson marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe maqedonasve. Nëse maqedonasit nuk dëshirojnë që gjuha shqipe të jetë zyrtare, atëherë le të shkojmë drejt federalizmit për shkak se ne nuk mund t'i presim ata që vazhdimisht të na i përcaktojnë të drejtat tona", ka thënë Sinani.

Propozim-ligji për gjuhët e bashkësive etnike parashihet avancim të theksuar të përdorimit të gjuhës shqipe në të gjitha institucionet e nivelit lokal dhe shtetëror, si në Qeveri, Kuvend, gjyqësor dhe organe të tjera. (rfe)

LAJME SHKURT

Rama: Të gjitha strukturat e shtetit në terren

TIRANË, 4 SHKURT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka përshëndetur aksionin e institucioneve shtetërore për t'i bërë ballë motit të keq. Teksa shpërndan disa pamje nga operacionet në zona të ndryshme, Rama siguron se të gjitha strukturat do të jenë në gatishmëri deri në përmirësimin e situatës. "Që prej ditës së djeshme vazhdon pa ndërprerje angazhimi në terren i të gjitha strukturave të shtetit për përballimin e situatës së krijuar nga moti i rënduar si dhe për të qenë pranë familjeve të prekura", ka shkruar Rama në "Facebook", teksa ndan edhe një galeri fotografish.



Vota kundër ShBA-së, shqiptarët e Amerikës kryqëzojnë Pandeli Majkon

TIRANË, 4 SHKURT - Shqiptarët e diasporës që jetojnë në ShBA e kanë gozhuar me pyetje ministrin e Diasporës, Pandeli Majko, gjatë vizitës së tij në Amerikë. Gjatë një takimi me emigrantët shqiptarë që jetojnë në Detroit, Majko është pyetur se përse Shqipëria votoi kundër ShBA-së në OKB dhe pse në Shqipëri janë rikthyer sërish simbolet e komunizmit.

Gjithashtu, shqiptarët që jetojnë në Amerikë ndjekin me vëmendje edhe zhvillimet politike që ndodhin në Shqipëri, ku një prej pyetjeve ishte a do të arrestohet Saimir Tahiri. Këto pyetje Majkos i janë bërë nga Gjon Kaçaj, i cili ka qenë i persekutuar në kohën e diktaturës.

Zyrtarët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë mbajtur konferencë për medie për çështjen e demarkacionit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi

Vetëvendosje nuk e voton demarkacionin, kërkon hetim nga prokuroria

Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, Ali Lajçi dhe Arbërie Nagavci, kanë kundërshtuar procedimin e demarkacionit në seancë plenare të Kuvendit të Kosovës. Ata kanë thënë se në vend se kjo marrëveshje t'u dërgohet deputetëve për ratifikim, duhet të dërgohet për hetim në prokurori. Sipas tyre, marrëveshja e demarkacionit me Malin e Zi është bërë gabimisht dhe, si e tillë, nuk do të votohet nga deputetët e Vetëvendosjes

EPOKA ERE Shqipëri HETIMI

Prishtinë, 4 shkurt - Një ditë para se kryesia e Kuvendit ta shqyrtojë marrëveshjen e demarkacionit të kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi, Lëvizja Vetëvendosje është shprehur kundër procedimit të kësaj marrëveshje në ndonjërin prej seancave të radhës të Kuvendit. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ali Lajçi, në një konferencë për medie të dielën ka thënë se kjo parti nuk ka ndryshuar qëndrimin sa i përket kësaj çështje për shkak të argumenteve të fuqishme që ka për ta mbrojtur territorin dhe sovranitetin e republikës. Ai ka theksuar se çdo tentim për ta vënë dhe ratifikuar këtë marrëveshje është i dështuar. "Kemi disa projekte përpara dhe kapituj të rëndësishëm që e definojnë Republikën e Kosovës si shtet sovran dhe të pavarur. Njëra prej këtyre është demarkacioni me Malin e Zi, i cili u punua në mënyrë joprofesionale nga komisioni i Murat Mehës i emëruar në atë kohë

nga kryeministri Hashim Thaçi. Një trend i tillë negativ vazhdoi edhe në kohën e qeverisjes së Isa Mustafës. Lëvizja Vetëvendosje mban qëndrimin e njëjtë për versionin aktual të demarkacionit dhe nuk lëviz për shkak të argumenteve të fuqishme dhe për shkak të orientimeve të saj për t'i mbrojtur territorin dhe sovranitetin e republikës. Deputetët e Vetëvendosjes dhe të partive të tjera nuk do ta ratifikojnë këtë version të kësaj marrëveshje. Prandaj, çdo tentim për ta vënë dhe ratifikuar këtë marrëveshje është e dështuar. Kufijtë e këtij versioni janë kufi të delimitimit dhe demaskimit që nuk lejohen as në pikëpamjet e të drejtave ndërkombëtare", ka thënë Lajçi. Ai ka kërkuar nga Mali i Zi që të rrijë urtë pasi, sipas tij, synimet ekspansioniste të këtij shteti nuk mund të kalojnë në Kuvendin e Kosovës. "Synimet ekspansioniste të Serbisë dhe Malit të Zi kanë qenë dhe mbasin, por me votën e lirë të deputetëve të Kuvendit të Kosovës nuk do të mund të kalohen. Qeverisë së Malit të Zi



i themi se synimet e tilla nuk kalojnë dhe ata duhet të jenë të urtë, të mençur, të qetë dhe të marrin për argument të gjithë historiografinë e vet, të gjithë historinë shtetërore të Malit të Zi, sidomos prej viteve 1945-1946, kur vijat kufitare janë të ratifikuara dhe kanë mbetur si të tilla pa lëvizur", është shprehur Lajçi. Edhe deputetja Arbërie Nagavci ka pohuar se ky version i demarkacionit nuk duhet të dërgohet në Kuvend për miratim por, sipas saj, duhet të dërgohet në prokurori. "Marrëveshja e pretenduar për shënimin e vijës kufitare nuk

duhej të vinte fare në Kuvend. Përmbajtja e asaj marrëveshje, personat e përfshirë në atë komision, si dhe përfaqësuesit politikë, pra nënshkruesit e saj, duhet të ishin para një procesi gjyqësor për cenimin e tërësisë territoriale të Kosovës. Prandaj sa më parë të nisin hetimet për këtë rast të rëndë dhe të paprecedentë", ka deklaruar Nagavci. Ajo i ka bërë thirrje Kryesisë së Kuvendit dhe anëtarëve të saj të mos përfshihen në cenimin territorial të vendit. Po ashtu, Nagavci i ka bërë thirrje Qeverisë Haradinaj që sa më shpejt Malin e Zi t'i fillojë bisedimet për ta korrigjuar ver-

sionin aktual të demarkacionit. Edhe Nagavci ka theksuar se nëse Kryesia e Kuvendit e procedon për seancë marrëveshjen aktuale të demarkacionit, nuk do të mbështetet nga shumica e deputetëve. "Shpresojmë që deputetët do të jenë në nivel të kryerjes së detyrës, pra nuk do t'i shkelin obligimet e tyre ligjore dhe kushtetuese për cenim të integritetit territorial. Edhe nëse vjen në seancë kjo marrëveshje nuk do ta marrë mbështetjen e shumicës së deputetëve të Kuvendit të Kosovës", ka është shprehur Nagavci.

Sholtes: Takimi Haradinaj-Markoviq, mundësi për zgjidhjen e demarkacionit



PRISHTINË, 4 SHKURT - Raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian, Igor Sholtes, ka thënë se takimi i së martës në mes të kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj dhe atij të Malit të Zi, Dushko Markoviq, do të jetë mundësi që të arrihet shansi për një zgjidhje të shpejtë, e cila do t'u mundësonte qytetarëve të Kosovës liberalizimin e vizave. "Mendoj se gjërat janë relativisht të qarta. Demarkacioni i kufirit me Malin e Zi është një prej kushteve më të rëndësishme për liberalizim vizash për qytetarët e Kosovës. Natyrisht, përveç luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit", ka thënë Sholtes për të përdit-

shmen malazeze "Pobjeda". Sipas tij, topi tashmë është në anën e politikanëve të Kosovës të cilët duhet të kenë dy të tretat e votave në Kuvend në mënyrë që ta ratifikojnë marrëveshjen për demarkacion. Ai ka thënë se gjatë vizitës së kryeministrit malazez në Kosovë mund të ketë lëvizje përpara. "Mund të arrihet edhe ndonjë zgjidhje tjetër që do të mund të çonte në zhblokim në Kuvendin e Kosovës, ndonjë formulë e dytë apo e tretë përmes së cilës do të zgjidhej çështja e demarkacionit të kufirit. Por, për këtë mund të flasim pas takimit mes dy kryeministrave", ka theksuar Sholtes.

Flet për "Epokën e re" zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Burim Ramadani

Transformimi në Forca të Arma

Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Burim Ramadani, ka bërë me dije se transformimi i FSK-së në Forca të Armatosura është proces i pakthyeshem dhe i sigurt. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se ky proces garanton sigurinë e të gjithë qytetarëve të Kosovës, të të gjitha komuniteteve, si dhe kontribuon në sigurinë rajonale. Ramadani ka mohuar çdo mundësi që çështja e formimit të ushtrisë të bëhet pjesë e procesit të dialogut Kosovë - Serbi në Bruksel. Sipas tij, ky proces është në rrugën e mirë dhe nuk ndërlidhet me asnjë proces tjetër. Ramadani ka folur edhe për qeverisjen Haradinaj. Ai ka thënë se kjo Qeveri është më dinamika që ka pasur ndonjëherë Kosova. Ramadani ka theksuar se kjo periudhë nëpër të cilën po kalojmë, kërkon racionalitet politik e qytetar nga të gjithë, në veçanti nga opozita

EPOKA E RE **Muhamet KOCI****PRISHTINE, 4 SHKURT**

Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Burim Ramadani, është shprehur i bindur se transformimi i FSK-së në Forca të Armatosura është proces i sigurt dhe i pakthyeshem. Ai ka bërë me dije se ky proces do t'i bëjë më të sigurt Kosovën dhe rajonin. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ramadani ka thënë se transformimi i FSK-së në Forca të Armatosura është objektivi nacional i Qeverisë së Kosovës ku, sipas tij, ka angazhim të plotë në baza ditore të punës. "Procesi i transformimit nuk është dhe nuk duhet të shihet si një proces në të cilin votoja mund të përdoret përgjithnjë. Transformimi në FAK është proces i pakthyeshem. Për më shumë, kjo do ta bëjë më të sigurt Kosovën dhe do të kontribuojë në sigurinë rajonale", ka thënë Ramadani. Ai ka treguar se të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës janë të angazhuara që ky proces të ndodhë sa më shpejt, duke shtuar se askush nuk mund ta përdorë veton ndaj transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura. "Kryeministri Haradinaj, Qeveria, Presidenca dhe Kuvendi i Kosovës, janë të angazhuara në baza ditore për punën e përbashkët me të gjithë përfaqësuesit politikë të qytetarëve të Kosovës, përfshirë këtu komunitetet j-shumicë, në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ofrimin e mundësive për integrim të plotë të të gjithë qytetarëve të Kosovës, perspektivë, siguri dhe mirëqenie. Për Qeverinë e Kosovës puna në këtë drejtim është e përditshme, jo e izoluar", ka thënë Ramadani.

Ai ka mohuar çdo mundësi që çështja e formimit të ushtrisë të bëhet pjesë e procesit të dialogut Kosovë - Serbi në

Bruksel. "Kosova dhe Serbia kanë shumëçka për të biseduar. Unë u takoj atyre që mendojnë se dialogu nuk ka alternativë më humane. Një varg temash që lidhen me procesin e njohjes reciproke mund të jenë në tavolinë. Porse, transformimi i FSK-së në FAK, sikurse edhe kompletimi i arkitekturës së sigurisë kombëtare të Kosovës, është krejtësisht proces i brendshëm i Kosovës. Si i tillë, ky proces është në rrugën e mirë, të sigurt, të garantuar dhe nuk ndërlidhet me asnjë proces tjetër. Ato janë tema të ndara dhe procese të ndara", është shprehur Burim Ramadani, zëvendësministër i FSK-së.

"Epoka e re": Z. Ramadani, sipas barometrit të sigurisë së realizuar nga QKSS-ja, FSK-ja vazhdon të jetë institucioni më i besueshëm tek qytetarët. Çfarë do të thotë kjo për këtë institucion dhe për institucionet e tjera që besimi është më i ulët?

Ramadani: Është e qartë, në bindjen time, se FSK-ja është institucioni që ruan primatin e besueshmërisë së qytetarëve. Kjo vërehet për çdo ditë si në nivelin e komunikimeve politike në menaxhmentin e lartë, po ashtu edhe në marrëdhëniet e drejtpërdrejta të institucionit me komunitetet dhe qytetarët. Profesionaliteti, multietniciteti, angazhimi i pakursyer për qytetarët, aktivitetet e shumta humanitare, mbështetja për autoritetet civile në nivel qendror e lokal, si dhe shumë faktorë të tjerë kanë bërë që FSK-ja ta ruajë primatin dhe ta rrisë besueshmërinë e qytetarëve ndaj saj. Kjo është krenari për institucionin, pjesëtarët e saj, partnerët mbështetës ndërkombëtarë dhe Kosovën në tërësi. Në të njëjtën kohë, është për t'u vlerësuar lart fakti se skena politike në përgjithësi ka pasur vazhdimisht konsensus mbi trajtimin e FSK-së, duke e larguar atë nga debati i politikës ditore.

"Epoka e re": Jemi në prag të 10-vjetorit të pavarësisë. Cilat do të jenë aktivitetet në të cilat do të marrë pjesë kjo forcë për këtë përvjetor?

Ramadani: Shënimi i 10-vjetorit të pavarësisë do të jetë një festë 10-ditore në promovim të këtij viti që shënon një dekadë shtet. FSK-ja edhe këtë herë, në kuadër të mandatit që ka, do të na bëjë krenarë të gjithëve. Ndërsa një ditë e veçantë do të jetë për FSK-në, për aktivitetet të ndryshme, në të cilën qytetarët dhe të gjithë në Kosovë do të ndihen mirë që kanë një institucion të këtillë dhe profesional.

"Epoka e re": Ka disa vjet që FSK-ja pret vendimin politik për t'u transformuar në Forca të Armatosura. Sipas jush, a është e gatshme FSK-ja për t'u transformuar?

Ramadani: Transformimi i FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK) është objektivi i Qeverisë së Kosovës dhe objektivi nacional për të cilin ka angazhim të plotë në baza ditore të punës. Kryeministri Haradinaj, Qeveria e Kosovës dhe Ministria e FSK-së janë të përkushtuar për përmbylljen me sukses të plotë të këtij procesi, si një prej hapave më të rëndësishëm në sigurinë e Kosovës dhe kontributin për sigurinë rajonale e më gjerë. Vazhdimi i avancimit të qeverisjes së mirë, multietnicitetit dhe profesionalizmit, mbikëqyrjes civile demokratike mbi sektorin e sigurisë, avancimi i rregulloreve dhe normave të tjera juridike relevante, avancimi i procesit të planifikimit, buxhetimit dhe operacionalizimit në institucionet e sigurisë, rritja e shërbimit për qytetarët dhe komunitetet në Kosovë, sikurse edhe rritja e nivelit të bashkëpunimit bilateral dhe multilateral me shtete dhe organizata të rëndësishme, janë pjesë e angazhimeve të kryeministrit, Qeverisë, MFSK-së



dhe institucioneve të tjera të Kosovës. Në aspektin operacional, FSK-ja ka marrë vlerësimet më të larta edhe nga NATO për përmbylljen e kapaciteteve operacionale. Procesi i transformimit është vendimarrje politike, derisa për të gjithë ne është shumë më e lehtë bazuar në faktin se kemi të bëjmë me një institucion që tashmë ka arritur suksese të mëdha. FSK-ja është e përgatitur në aspektin profesional,

operacional dhe në shërbim të qytetarëve. Sot FSK-ja është profesionale, multietnike, si dhe e trajnuar mbi standardet dhe parimet demokratike të forcave të sigurisë. Transformimi i FSK-së në FAK është proces që garanton sigurinë e të gjithë qytetarëve të Kosovës, të të gjitha komuniteteve, si dhe kontribuon në sigurinë rajonale. Procesi do të jetë një sukses i garantuar dhe i sigurt, me përfshirje maksimale

tosura, proces i pakthyeshëm



të të gjitha komuniteteve në Kosovë.

"Epoka e re": Dihet se në këtë çështje është pengesë Lista Serbe. Si ministri dhe Qeveri, keni arritur t'ua ndryshoni qëndrimin deputetëve serbë?

Ramadani: Kryeministri Haradinaj, Qeveria, Presidenca dhe Kuvendi i Kosovës janë të angazhuar në baza ditore për punën e përbashkët me të gjithë përfaqësuesit politikë të

qytetarëve të Kosovës, përfshirë këtu komunitetet joshumicë, në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ofrimin e mundësive për integrim të plotë të të gjithë qytetarëve të Kosovës, perspektivë, siguri dhe mirëqenie. Për Qeverinë e Kosovës, puna në këtë drejtim është e përditshme, jo e izoluar.

"Epoka e re": Deri kur do të pritet të binden deputetët serbë, apo do të shkohet me

planin "B", duke e transformuar FSK-në me ligj?

Ramadani: Angazhimi ynë institucional është i koordinuar mirë dhe gjithëpërfshirës, me qëllim që procesi të përmbyllet në rrugë kushtetuese e ligjore dhe ta ketë mbështetjen e plotë të partnerëve mbështetës. Nuk mund të flas për kushtëzime as përmbajtjesore dhe as kohore. Procesi i transformimit nuk është dhe nuk duhet të shihet si një proces në të cilin vetoja

mund të përdoret përgjithnjë. Transformimi në FAK është proces i pakthyeshëm. Për më shumë, kjo do ta bëjë më të sigurt Kosovën dhe do të kontribuojë në sigurinë rajonale.

"Epoka e re": Është thënë se kjo çështje mund të bëhet edhe pjesë në bisedimet në Bruksel. A ka nevojë për një gjë të tillë të shtohet si temë e re në procesin e dialogut?

Ramadani: Kosova dhe Serbia

kanë shumëçka për të biseduar. Unë u takoj atyre që mendojnë se dialogu nuk ka alternativë më humane. Një varg temash që lidhen me procesin e njohjes reciproke mund të jenë në tavolinë. Porse, transformimi i FSK-së në FAK, sikurse edhe kompletimi i arkitekturës së sigurisë kombëtare të Kosovës, është krejtësisht proces i brendshëm i Kosovës. Si i tillë, ky proces është në rrugën e mirë, të sigurt, të garantuar dhe nuk ndërlidhet me asnjë proces tjetër. Ato janë tema të ndara dhe procese të ndara.

"Epoka e re": Ju jeni emëruar zëvendësministër nga AAK-ja. A besoni se me gjithë këto tema të mëdha që ka Kosova para vetes, kjo Qeveri nën drejtimin e Haradinajt do të mund t'i kalojë demarkacionin, asociacionin dhe Gjykatën Speciale. Apo mund të shihet si zgjedhje shkuarja në zgjedhje të reja, kështu së paku po ka deklarime nga opozita.

Ramadani: Qeveria Haradinaj është qeveria më dinamike që ka pasur Kosova. Me vendim-marrje dhe me përmirësim të aspekteve edhe strategjike edhe praktike. Periudha nëpër të cilën po kalojmë patjetër se kërkon racionalitet politik e qytetar nga të gjithë, në veçanti nga opozita. Asnjëra prej temave të tilla nuk është në të vërtetë temë zgjedhore. Nuk është se dikush do të duhej që në mënyrë joracionale të presë që Gjykata Speciale apo ndonjë temë tjetër t'i sjellë fitore në zgjedhje, duke synuar ta ngarkojë Kosovën me tensione të panevojshme.

Kryeministri Haradinaj i ka dhënë shpirt qeverisjes dhe jo vetëm formalitetit institucional. Një dinamizim i tillë sigurisht se është parë me shqetësim nga grupe politike, që deri në një farë mase është edhe shqetësim legjitim politik. Por, nuk është i vërtetë si përmbajtje. Kemi parë, për shembull, gjatë këtyre javëve të fundit, një kauzë politike të brendshme, kinse Kosova po izolohet, sikurse thuhej "më së keqi që nga çlirimi" dhe që ishte kauzë false dhe e padrejtë. Ishte, sikurse zakonisht ndodh, për poenë politike të brendshme, kryesisht nga ata që mbeten një kohë tashmë pa kauzë politike. Pasi zbrazën "arsenalin" e narracionit politik me qëllime krejtësisht të konsumit të brendshëm, sërish të gjithë e shohim se asgjë nuk pati të bëjë me të vërtetën. As nuk izolohemi dhe as nuk funksionojnë kauzat false.

Lista Serbe, pa qëndrim për demarkacionin

PRISHTINË, 4 GUSHT - Lista Serbe ende nuk ka vendosur se cili do të jetë qëndrimi i deputetëve të saj në Kuvendin e Kosovës në rast se marrëveshja për shënjimin e vijës kufitare me Malin e Zi sillet në legjislativ për t'u ratifikuar.

Igor Simiq, deputet i Listës Serbe në Kuvendin e Kosovës dhe zëdhënës i këtij subjekti, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se çështja e ratifikimit të kësaj marrëveshjeje nuk paraqet ndonjë prioritet për këtë subjekt politik parlamentar, i cili është pjesë e koalicionit qeverisës. Deri më tash, sipas tij, lidhur me këtë çështje nuk ka pasur fare konsultime me subjektet e tjera, të cilat janë partnere në koalicionin qeverisës. "Nuk do të mund të jepja, në këtë moment, sqarime lidhur me këtë çështje. Demarkacioni si çështje nuk është në kreun e prioritetëve, kur bëhet fjalë për punën e deputetëve serbë në Kuvendin e Kosovës. Kur bëhet fjalë për obligimet, të cilat Kosova i ka marrë në raport me bashkësinë ndërkombëtare, për ne prioritet është formimi i bashkësisë së komunave me shumicë serbe. Për demarkacionin ne nuk kemi biseduar as me partnerët e koalicionit në periud-

hën e kaluar. Por, e dimë se brenda korpusit politik të përfaqësuesve shqiptarë jo vetëm ndërmjet opozitës dhe pushtetit, por edhe brenda vetë pushtetit, ekzistojnë mendime të ndryshme", ka thënë Simiq. Ai ka shtuar se pavarësisht që për Listën Serbe formimi i asociacionit apo bashkësisë së komunave me shumicë serbe është kulmi i prioritetëve të këtij subjekti, megjithatë nuk do ta ndërlihdë në asnjë mënyrë me çështjen e ratifikimit të marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi dhe votat e këtij subjekti për ose kundër këtij ratifikimi. "Nuk do të tregtojmë në atë mënyrë. Kur kemi hyrë në formimin e kësaj qeverie, në mënyrë të qartë e kemi paraqitur qëndrimin se nuk do t'i bëjmë shantazh askujt. Do të luftojmë për interesat e serbëve, por nuk do ta shantazhojmë askënd. Formimi i bashkësisë së komunave serbe është obligim ndërkombëtar i Kosovës dhe ne jemi këtu t'ia përkujtojmë këtë dhe të përpiqemi që kjo të vijë sa më shpejt në rend dite. Nuk do të lejojmë që kjo të jetë pjesë e tregtimit, demarkacioni për bashkësinë e komunave serb apo të ngjashme", ka theksuar



Simiq. Sipas tij, Lista Serbe do ta bëjë të qartë vendimin lidhur me votimin për ose kundër ratifikimit të marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi atëherë kur kjo çështje do të futet në rend të ditës në Kuvendin e Kosovës. "Të mos flasim paraprakisht, sepse kjo bie në nivelin e spekulimeve.

Kur të vijë në Kuvend, Lista Serbe do ta shprehë në mënyrë të qartë qëndrimin e vet", ka deklaruar Simiq.

Për ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi, e cila është marrëveshje ndërkombëtare për Kosovën, nevojiten dy të tretat e votave të deputetëve të Kuvendit të

Kosovës, i cili ka 120 ulëse. Kjo javë mund të jetë vendimtare për Kosovën nëse do të arrijë ta zë afatin e fundit për t'u përfshirë në agjendën evropiane, duke ratifikuar marrëveshjen e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, si kriteri i fundit i Bashkimit Evropian për heqjen e vizave.

Gashi: Një nga qendrat kryesore kulturore për diasporën do të jetë në Nju Jork



NJU JORK, 4 SHKURT (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, njëherësh ministër i Diasporës, Dardan Gashi, po qëndron në Nju Jork, ku është takuar me kryesinë e Shoqatës "Vatra". Gjatë takimit me drejtuesit e shoqatës pan-shqiptare në ShBA, Gashi ka informuar për punën e ministrisë dhe projektet të cilat presin të realizohen gjatë këtij viti.

Ministri Gashi ka njoftuar të pranishmit për marrëveshjet e

nënshkruara me Republikën e Shqipërisë, të cilat, sipas tij, lidhen drejtpërsëdrejti me diasporën, duke u koncentruar në themelimin e qendrave të përbashkëta në diasporë. "Këto qendra të shërbejnë si adresa e parë e bashkëpunimit dhe ndërveprimit institucional mes qeverisë së Kosovës dhe Shqipërisë dhe bashkatdhetarëve tanë. Një nga qendrat kryesore kulturore për diasporën do të jetë në Nju Jorku", ka thënë ministri Gashi.

Moti në pesë ditët e ardhshme

PRISHTINË, 4 SHKURT (ER) - Sipas Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK), gjatë kësaj jave do të mbajë mot i ndryshueshëm, i vranët dhe me intervale me diell. IHMK-ja ka bërë me dije se pritet të ketë riga lokale shiu të cilat do të shtrihen

kryesisht në jugperëndim dhe juglindje të vendit. Gjatë ditëve të ardhshme shtypja atmosferike do të ketë luhatje mbi dhe nën vlerat e normales duke e mbajtur një gjendje të ndryshueshme termike. Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet -2 deri 2

gradë celsius, ndërsa maksimalin e ditës parashihet të lëvizin ndërmjet 7-11 gradë celsius.

Të mërkurën nuk përjashtohen mundësitë për ndonjë rigë lokale të shiut. Do të fryjë erë nga verilindja dhe jugperëndimi me shpejtësi deri 8m/s.



Përmirësohet niveli i ajrit në kryeqytet

Cilësia e ajrit në Prishtinë vazhdon të jetë dukshëm më e mirë krahasuar me një javë më parë, kur kryeqyteti i Kosovës bënte pjesë në qytetet me cilësinë e ajrit më të ndotur në botë. Nënkrjetari i Komunës së Prishtinës, Selim Pacolli, ka thënë se nga matjet e fundit që janë bërë, gjendja e ajrit në Prishtinë është më e mirë

EPOKA ERE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 4 SHKURT - Nënkrjetari i Komunës së Prishtinës, Selim Pacolli, ka bërë me dije të dielën se gjendja e ajrit në kryeqytet tashmë është shumë e mirë. Prishtina, e cila ishte në listën e vendeve më të ndotura, tani

gjendet në pozitat e fundit, çfarë nënkupton se niveli i ndotjes së ajrit është përmirësuar dukshëm. "Sot në orën 6:50. Jo çdo herë të parët për të keq, por sot ishim të parët për të mirë", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook". Me qëllim të uljes së nivelit të ndotjes së ajrit në kryeqytet,



Komuna e Prishtinës, së bashku me disa ministri përkatëse, pati marrë vendim të ndalohet qarkullimi i të gjitha automjeteve brenda qytetit. Ky vendim zgjati vetëm një ditë dhe pastaj u shfuqizua.

Ndërkaq Kuvendi i Kosovës me 73 vota për ka miratuar një rezolutë për gjendjen alarmante të ndotjes së ajrit në Prishtinë. Deputetët e Kuvendit të Kosovës përmes kësaj rezolute kanë kërkuar që mbrojtja e ambientit të shndërrohet në prioritet shtetëror të Qeverisë së Kosovës. Me këtë rezolutë deputetët kanë kërkuar vendosjen e elektrofiltrave të cilësisë së duhur në termocentralet e KEK-ut deri në fund të vitit 2018. "Të bëhet

kontroll i cilësisë së karburanteve dhe gazit sipas ligjeve në fuqi deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2018. Të ndahet buxhet për izolimin e ndërtesave publike, me prioritet objektet shëndetësore dhe arsimore. Qeveria obligohet ta shikojë mundësinë të ndajë buxhet shtesë që t'i shtohen mjeteve Korporatës Sfidat e Mijëvjeçarit të ShBA-së në vlerë prej 22 milionë dollarësh, me qëllim që t'i ndihmojë projektet e ndërlidhura me efikasitet. Të shtohen investimet kapitale për ngrohtoren "Termokos", për dyfishim të kapaciteteve të koogenerimit", është thënë në tekstin e rezolutës së miratuar. Kuvendi i Kosovës ka kërkuar nga komunat t'i shikojnë me

urgjencë politikat e subvencionimit të ekonomive familjare si dhe të merret vendim për ndalim të thyerjes së objekteve kolektive. Po ashtu, edhe disa qindra qytetarë të Prishtinës, me moton "Dua ajër të pastër", kanë protestuar në Sheshin "Skënderbeu" dhe para objektit të Kuvendit të Kosovës, me qëllim të sensibilizimit të opinionit dhe institucioneve të vendit për nivelin alarmant të cilësisë së ajrit në kryeqytet.

Më herët të dhënat që ka ofruar Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë për matjen e cilësisë së ajrit kanë treguar se vlerat e PM 2.5 janë disa herë jashtë normales.

Ranking	News	Resources
65	Moscow, Russia	20
66	Osaka, Japan	18
67	Brussels, Belgium	18
68	Madrid, Spain	17
69	Munich, Germany	17
70	Berlin, Germany	16
71	Portland, USA	15
72	Sydney, Australia	14
73	Seattle, USA	14
74	Poznan, Poland	14
75	Bern, Switzerland	13
76	Zagreb, Croatia	8
77	Pristina, Kosovo	4

Policia shqipton 30 mijë gjoba



PRISHTINË, 4 SHKURT (ER) - Policia e Kosovës ka shqiptuar mbi 30 mijë dënime në trafik gjatë muajit janar. Në kuadër të këtyre autorizimeve dhe kompetencave gjatë periudhës kohore 1. 1. 2018 deri 31. 1. 2018 janë identifikuar një numër i konsiderueshëm i kundërvajtësve, ndaj të cilëve Policia e Kosovës ka ndërmarrë

të gjitha veprimet të cilat dalin nga ligjet. "Policia e Kosovës apelon tek të gjithë pjesëmarrësit në trafikun rrugor që t'u përmbahen dispozitave ligjore, të rritet vigjencia, të shtohet kujdesi për respektimin e rregullave që dalin nga ligjet e trafikut, për të garantuar një siguri më të madhe, me qëllim të shmangies së aksi-

denteve rrugore në tërësi, në veçanti të atyre me pasoja fatale", është thënë në njoftimin e policisë.

Policia e Kosovës ka njoftuar se edhe pse nuk ka qëllim primar ndëshkimin, do të vazhdojë ta aplikojë ndërmarrjen e masave ligjore për të gjithë pjesëmarrësit në trafikun rrugor që bien ndesh me ligjet e trafikut.

Presidenti Thaçi pinë kafe me dy kryetarët e dy komunave të Drenicës

DRENAS, 4 SHKURT (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, është takuar të dielën me kryetarin e Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari dhe atë të Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci.

Ky i fundit ka shkruar në profilin e vet në "Facebook", se ky takim ishte përtej çdo politike. "Pata kënaqësinë që së bashku me miqtë e mi, me presidentin Thaçi, kryetarin dhe nënkryetarin e Skenderajt, Bekim

Jasharin dhe Nuredin Lushtakun, të pimë kafe, në Drenicë, përtej çdo politike. E kaluara me të tashmen japin optimizëm dhe zgjidhje të mira për të ardhmen tonë", ka shkruar Lladrovci.





NEGLIZHENCAT POLITIKE DHE INTERESAT BIZNESORE PAMUNDËSUAN KYÇJEN E KOSOVËS NË TAP

Njohësit e çështjeve ekonomike, Safet Gërxhaliu dhe Blerim Grainca, kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se rëndësia ekonomike, integruuese, sociale dhe strategjike e kycjes së Kosovës në gazsjellësin Trans-Adriatik (TAP) nuk është marrë seriozisht nga institucionet e Kosovës. Ata kanë theksuar se në këtë proces ka dominuar agjenda politike dhe ndikimet biznesore të importuesve të gazit në Kosovë

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 JANAR - Gazsjellësi Trans-Adriatik (TAP) është konsideruar investimi më i madh në historinë e shtetit shqiptar jo vetëm nga shuma monetare, por edhe nga rëndësia strategjike dhe integruuese. Mirëpo këtë fat nuk e pati edhe Kosova, ani pse ligjvënësit e legjislaturës së kaluar prematuan gjetje të mënyrës për t'u

kyçur në këtë rrjet edhe Kosova. Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) është një projekt për zhvillimin e një tubacioni që do të transportojë gaz natyror nga rajoni Kaspik në drejtim të Evropës. Në korrik të vitit 2015, kur u hap zyrtarisht fillimi i punimeve për ndërtimin e projektit, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, pati dhënë dritën jeshile se në këtë projekt mund të kyçet edhe Kosova. Sipas tij, ndërtimi i një segmenti të TAP-

it deri në Kosovë do të përbëjë "de facto" autostradën e dytë energjetike mes dy vendeve tona. "Ne jemi të angazhuar ta kthejmë TAP-in në një burim zhvillimi jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për Kosovën. Ndërtimi i një segmenti të TAP-it deri në Kosovë do të përbëjë 'de facto' autostradën e dytë energjetike mes dy vendeve tona, pas përfundimit të linjës së tensionit të lartë, që po ecën me shumë

shpejtësi, me cilësi të lartë dhe pa diskutim që do të jetë gati vitin e ardhshëm", pati thënë kryeministri Rama. Lidhur me këtë çështje ka folur kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se sikurse vendimmarrësit në Kosovë ta dinin rëndësinë e kycjes në TAP do të bënin më shumë në këtë drejtim. Sipas Gërxhaliut, më mirë është të investohet në kycjen e Kosovës

në këtë rrjet sesa të shtrohen kilometra asfalt. Ai ka theksuar se përfitimet nga TAP-i do të jenë ekonomike, sociale dhe integruuese. "Është shqetësuese që për një projekt të rëndësishëm nuk flitet fare në Kosovë. Si duket problemet politike dhe tentativa e dominimit të partive politike është mbi interesat e shtetit. Shtrohet pyetja se çfarë mund të jetë substancë e zhvillimit dhe e qëndrueshmërisë ekonomike të Kosovës në të ardhmen përveç kycja në TAP", ka deklaruar Gërxhaliu, duke shtuar se kycja në TAP është një mekanizëm i forcimit të partneritetit me fuqitë më të mëdha në botë.

Ai ka theksuar se Kosova nuk e meriton të jetë e izoluar. "Shikoni se çfarë ndodh në Bullgari, Rumani, Shqipëri, Itali dhe Mal të Zi. Pse vetëm Kosova të mbetet gjithmonë e getoizuar. Kjo nuk është e drejtë. Prandaj po ta dinim rëndësinë e TAP-it vendimmarrësit në Kosovë do të shqetësoheshin më shumë dhe do ta vënin si prioritet të shtetit. Sot gazi është një përdorues strategjik nga i cili nuk varet vetëm Ballkani, por edhe Evropa. Dua të besoj se në të ardhmen e afërt dikush do ta kuptojë këtë rëndësi dhe prioritet. Do të duhej të bëhej një

MZhE-ja: Planifikohet që studimi i fizibilitetit të kryhet në vitin 2018

Departamenti i Energjisë në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në përgjigjen e dhënë për gazetën "Epoka e re", ka theksuar se është duke u planifikuar që studimi i fizibilitetit të kryhet në vitin 2018. "Me qëllim të hapjes së perspektivës së zhvillimit të gazit natyror në Kosovë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me ish-Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë të Republikës së Shqipërisë, tani Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në vitin 2016 kanë aplikuar me projekt të përbashkët në kuadër të raundit të 15 në WBIF për realizimin e studimit të fizibilitetit të gazsjellësit Shqipëri - Kosovë, përmes gazsjellësit - IAP. Me të njëjtin projekt Kosova me Shqipërinë kanë aplikuar edhe në Komunitetin e Energjisë për përfshirjen e këtij projekti në kuadër të projekteve me interes për komunitetin e energjisë (PECI - listës 2016). Si promotor i aplikimit të përbashkët për këtë projekt ka qenë dhe është pala nga Shqipëria, përkatësisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Në tetor 2016 projekti i përbashkët i iniciuar me Shqipërinë është miratuar nga Këshilli i Ministrave të

Komunitetit të Energjisë dhe ka hyrë në kuadër të projekteve me interes në Komunitetin e Energjisë (PECI-list 2016). Paralel me këtë proces dhe me qëllim të realizimit të këtij projekti përmes palës nga Shqipëria në kuadër të Raundit të 15 në WBIF është aplikuar për realizimin e studimit të fizibilitetit të gazsjellësit Shqipëri - Kosovë", është thënë në përgjigjen elektronike të Departamentit të Energjisë.

Më tej, në këtë përgjigje thuhet se përmes platformës WBIF është aprovuar një grant në vlerën prej 300 mijë eurosh për realizimin e studimit të përbashkët të parafizibilitetit për gazsjellësin Shqipëri - Kosovë (ALKOGAP). "Studimi në fjalë do t'i japë rekomandimet përkatëse në mënyrë që pas-taj konform tyre të procedohet tutje me studime pasuese. Procesi gjendet në fazën e finalizimit të TeR nga konsulenca IFICO, për të vazhduar me procedurat e mëtejme të realizimit të studimit. Planifikohet që ky studim i parafizibilitetit të përfundojë në vitin 2018", është bërë me dije në përgjigjen e Departamentit të Energjisë që vepron në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

hej një kycje nga Shqipëria. Kjo kycje siguron furnizimin me gaz për amvisëri dhe për prodhim", ka thënë Grainca, duke shtuar se nuk është vonë të gjendet mënyra për kycje në TAP, qoftë edhe përmes partneritetit publiko-privat. Ai ka bërë me dije se kjo iniciativë e tij nuk u përkrah as nga Kuvendi e as nga Qeveria. "Këtë çështje e kam ngritur në Komisionin për Zhvillim

Ekonomik, por edhe në diskutime me Qeverinë. Fatkeqësisht, kjo iniciativë nuk u përkrah në atë kohë për shumë arsye. Shumë njerëz që ishin të përfshirë në vendimmarrje nuk e kuptonin këtë proces ose ishin të ndikuar nga interesat biznesore të importit të gazit. Por, edhe tash nuk është vonë që Kosova të kycet në TAP", ka thënë Grainca.

Kurti: Raporti import-eksport, 1 me 10

PRISHTINË, 4 SHKURT (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka risjellë statistikën e raportit të importit dhe eksportit të vendit, ku theksohet dallimi 1 me 10, të cilat, sipas tij, nuk tregojnë aspak situatë të mirë. "Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, deficitit tregtar për muajin dhjetor 2017 u rrit për 8.5 % në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2016. Eksporti i mallrave në muajin dhjetor 2017 kishte vlerën 29.4 milionë euro, ndërsaq importi 297.3 milionë euro. Kështu, raporti eksport-import është veçse 1-10", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka theksuar se në dhjetor të vitit 2017 eksportet e Kosovës në Shqipëri ishin dyfish më të

mëdha sesa në Maqedoni dhe trefish më të mëdha sesa në Serbi ose Mal të Zi. "Në anën tjetër, importet e Kosovës ishin mbi katër herë më të mëdha nga Serbia sesa nga Shqipëria. Ja se çfarë shifrash kemi për pasqyrë në vigjilje të shënimit të 10-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës. As sovranizimi shtetëror, as zhvillimi ekonomik dhe as patriotizmi nuk e kanë kështu", ka deklaruar Kurti. Lideri i LV-së ka thënë se tri reformat drejt shtetit zhvillimor (Fondi Sovran, Agjencia e Zhvillimit, Banka Zhvillimore), të cilat i patën prezantuar gjatë fushatës për zgjedhjet e 11 qershorit 2017, janë rruga e duhur dhe zgjidhja e vetme.



lobim përmes miqve ndërkombëtarë që edhe Kosova të jetë pjesë e këtij procesi", është shprehur Gërçhalu.

Blerim Grainca, ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, i cili në mandatin e kaluar ka qenë anëtar i komisionit për Zhvillim Ekonomik, ka thënë se kycja e Kosovës në TAP do të ndikonte në zhvillimin ekonomik dhe social.

Grainca, i cili ishte propozues dhe iniciues i nismës për t'u integruar në këtë rrjet, ka pohuar se e gjithë kjo situatë po ndodh për faktin se nuk po e dinë rëndësinë e këtij projekti individët që ishin vendimmarrës. "Kam qenë propozues dhe kam ngulur këmbë për rëndësinë e kycjes së Kosovës në TAP. Duhet të bëhet studimi i fizibilitetit pasi ky projekt kalon në Shqipëri dhe mund të mendo-

ATK-ja në vitin 2017 ka mbyllur 214 lojëra të fatit

PRISHTINË, 4 SHKURT - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) në vitin 2017 ka mbyllur 214 lojëra të fatit dhe ka anuluar 179 licenca. Gjëbata ndaj këtyre bizneseve arrijnë vlerën 1.3 milion euro.

Valentina Bytyqi, zyrtare për

komunikim me publikun në ATK, ka thënë se ky veprim është rezultat i fillimit të implementimit të strategjisë së re për monitorimin e lojërave të fatit. "Vetëm gjatë vitit 2017 ATK-ja ka vizituar 1 540 biznese të cilat ushtruan veprimtarinë e lojërave të

fatit, prej tyre janë mbyllur 214 lokale dhe janë anuluar licencat e 179 prej tyre", ka thënë Bytyqi për "Ekonomia Online". Ajo ka thënë se as këtë vit nuk do të ketë tolerime për ato biznese që ushtrjnë veprimtari të jashtëligjshme.



Reshjet e shiut shkaktojnë dëme të mëdha në disa komuna

EPOKA E RE Qendresa RAMA

DEÇAN, KAÇANIK, 4 SHKURT - Reshjet e shiut që ndodhën dy ditë e fundit në Kosovë kanë shkaktuar vërshime dhe dëme të konsiderueshme në disa komuna. Komunitet më të prekur nga këto vërshime janë Deçani, Kaçaniku, Juniku, Vitia, Prizreni e disa komuna të tjera më pak. Vërshimet në Deçan është thënë se kanë ndodhur si pasojë e mungesës së kanalizimit atmosferik. Për shkak të vërshimeve të shumta, komuna

emergjencës menjëherë ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për stabilizimin e gjendjes së krijuar në terren. Kemi angazhuar operatorët përgjegjës për parandalimin dhe evitimin e dëmeve të shkaktuara si pasojë e daljes së lumenjve Erenik dhe Trava", ka thënë ai.

Kuçi ka thënë se deri më tani dëme më të mëdha janë regjistruar në vendbanimet Goqaj, Zekaj, Qestaj, Gaxherr i Poshtëm, Jasiq dhe Gjocaj.

Nga vërshimet e reshjeve të shiut nuk ka shpëtuar as



kanë rënë pa ndërprerë janë shkakuar vërshime edhe në Komunën e Vitisë. Kryetari i

kësaj komune, Sokol Haliti, ka aktivizuar ekipin emergjent. Sipas tij, kjo u bë me qëllim që të

minimizohen dëmet. Haliti ka dalë në vendin e ngjarjes për t'i parë nga afër vendet ku rrezikshmëria nga vërshimet është më e madhe.

Pavarësisht prej kushteve të favorshme të tokës që ka Komuna e Vitisë për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore, ky territor vazhdimisht po dëmtohet nga reshjet, duke u përmbatur kështu fushat më pjellore të Budrikës, Remnikut, Skifterajt, Mogillës, Pozheranit dhe Klokotit.

e Deçanit dhe ajo e Junikut kanë formuar shtabet emergjente.

Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se ka pasur rritje të ujërave në qytet dhe nëpër fshatra si dhe ndërprerje të rrymës elektrike. Ai ka bërë me dije se rritja e ujërave ka penguar qarkullimin e udhëtarëve dhe rrezikuar bizneset dhe ekonomitë familjare. Ramosaj ka theksuar se kanë krijuar shtabin e emergjencave dhe i kanë marrë të gjitha masat. "Jemi duke u munduar të kontrollojmë dhe të përmirësojmë këtë situatë të krijuar", ka thënë Ramosaj.

Edhe kryetari i komunës së Junikut, Agron Kuçi, ka bërë me dije se pas reshjeve të fundit të shiut kanë formuar shtabin e emergjencës. "Shtabi i

Komuna e Kaçanikut. Kjo ka bërë që në disa rrugë të vështirësohet qarkullimi, madje një pjesë e qytetit edhe është bllokuar.

Kryetari i Kaçanikut, Besim Ilazi, ka thënë se tashmë rrugët janë të kalueshme, ndërsa ekipet për mirëmbajtjen e rrugëve janë duke punuar në terren.

Edhe kryetari i Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka folur për situatën e fundit të krijuar në këtë komunë pas reshjeve të dendura të shiut. Ai ka thënë se të reshurat e rrëmbyeshme të shiut kanë shkakuar rrëshqitje të madhe të dheut në fshatrat Nebregosht dhe Lokvicë. "Fatmirësisht, pos dëmeve materiale, nuk ka pasur të lënduar", është shprehur ai.

Pas reshjeve të fundit të shiut që



Hekurudhën e Kaçanikut e përfshinë uji

Si pasojë e reshjeve të mëdha të shiut, hekurudha për në Kaçanik është mbuluar nga uji. Menaxhmenti dhe punëtorët që mirëmbajnë hekurudhat kanë dalë në vendin e ngjarjes për ta zhbllokuar hekurudhën nga uji.

Shoferi në gjendje të dehur godet tri vetura

PRIZREN, 4 SHKURT - Policia e Kosovës (PK) ka njoftuar se një shofer i dehur gjatë drejtimit të veturës ka goditur tri vetura dhe rrethojat e rrugës. Si pasojë kanë mbetur të lënduar tre persona. "Raportohet se i dyshuari, përderisa ishte duke drejtuar



ar veturën nën ndikim të alkoolit, ka goditur tri vetu-

ra dhe disa rrethoja të metalta. Si pasojë, tre persona, një meshkuj dhe dy femra, kanë pësuar lëndime trupore dhe të njëjtit kanë pranuar tretman mjekësor. Nuk raportohet për të arrestuar", ka bërë me dije Policia e Kosovës.

Në Gjakovë vidhen orë dhe stoli në vlerë gjashtë mijë euro

GIKOVË, 4 SHKURT - Në rrugën "Anton Pashku" në Komunë të Gjakovës janë arrestuar dy persona të dyshuar pasi në shtëpinë e një personi kanë vjedhur dy orë dore dhe stoli ari, që dyshohen të jenë në vlerë rreth gjashtë mijë euro. Lajmin e ka bërë me dije Policia e



Kosovës. Me vendim të prokurorit të dyshuarit janë dërguar në mbajtje.

Demarkacioni: edhe ujku i ngopur, edhe tufa e dhenve e paprekur?



Islam LAUKA

Këto ditë janë shtuar përpjekjet për zbulimin e ideve "të reja", "krijuese" për zgjidhjen e çështjes së demarkacionit me Malin e Zi. Analistë, ekspertë dhe drejtues partish politike, janë vënë në garë, kush e kush të paraqitet me ide sa më "originale", në mënyrë që të mbetet në histori si njeriu që ua hapi rrugën e lëvizjes së lirë shqiptarëve të Kosovës dhe që arriti ta ruajtë të paprekur miqësinë e Kosovës me aleatët e saj strategjikë.

Midis këtyre ideve spikat ajo për ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit, duke i shtuar asaj një letër zotimi, në bazë të së cilës, Kosova dhe Mali i Zi pajtohen që, gjatë shënjimit të kufirit, t'i bëjnë korrigjimet përkatëse, mbi bazën e dokumenteve dhe fakteve të reja, të panjohura më parë. Sipas mbështetësve të kësaj ideje, ky proces duhet të kryhet brenda një afati prej dy vjetësh nga momenti i ratifikimit. Ata pretendojnë se kanë zbuluar formulën magjike të një kompromisi, të pranueshëm si për Prishtinën, ashtu edhe për Podgoricën, pra një zgjidhje që i nxjerrë të dyja

palët fituese. Me këtë formulë magjike të alkimistëve të rinj të Prishtinës, edhe ujku ngopet, edhe tufa e deleve mbetet e paprekur.

Duket paradoksale, por e njëjta formulë magjike po ofrohet, këto ditë, nga Athina për marrëveshjen detare me Shqipërinë, pra të ratifikohet ajo pastaj, gjatë zbatimit në terren, të merren parasysh pretendimet e Tiranës. Po si nuk ndodhi, qoftë edhe një herë të vetme, që fqinjët e shqiptarëve t'i ratifikojnë marrëveshjet sipas variantit tonë, pastaj gjatë zbatimit në terren ne t'i marrim në konsideratë pretendimet e tyre? Përse u dashka që gjithmonë shqiptarët t'i ratifikojnë marrëveshjet në bazë të kushteve që ua imponojnë fqinjët?

Ne duhet të vetëdijesohemi që jetojmë në shekullin e 21 dhe jo në epokën e mesjetës që njihet si koha e alkimistëve. Edhe këta të fundit duhet të vetëdijesohen për këtë fakt, sepse "zbulimet" e tyre nuk mund të shiten më si dikur. Duke iu rikthyer marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi, duket se më shumë se zgjidhje e problemit, "formula e re" përbën mashtrimin e radhës për popullin e Kosovës. Së pari, deri tani autoritetet zyrtare të Malit të Zi janë shprehur se e konsiderojnë të mbyllur, përfundimisht, çështjen e demarkacionit të kufirit me Kosovën. Në përgjigje të pyetjes, nëse po kërkohet ndonjë

zgjidhje tjetër, përfshirë atë për një letër zotimi, a deklaratë të përbashkët, këshilltari i kryeministrit të Malit të Zi, Srdjan Kusoviq, deklaroi se qëndrimi i vendit të tij nuk ka ndryshuar as nuk do të ndryshojë.

Së dyti, ta zëmë, në mënyrë hipotetike, se Mali i Zi bie dakord me formulën magjike të alkimistëve tanë. Çfarë do të thotë zbatimi i saj në praktikë? Asgjë më pak se përfjetësimi i kufirit midis dy vendeve tona në vijën Qafë Çakor-Kullë.

Ajo që alkimistët duan të na e shesin si "formulë të re" është po aq e vjetër sa historia e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në çdo marrëveshje demarkacioni ekziston një klauzolë për korrigjime që dikohen nga terreni, gjatë procesit të shënjimit të kufirit. Mundet, që në vende të caktuara, kufiri të shmanget pak nga ai që është fiksuar në letër, pra të mos vendoset në këtë shkëmb, por në atë tjetrin, jo në këtë përroskë, por në atë tjetër, jo në përllinë, por në rudinë, etj.

Këto janë shmangie të domosdoshme për shënjimin e kufirit në terren që, në aspektin e përfitimit të sipërfaqes, nuk kanë asnjë vlerë për palët. Në fund të këtij procesi hartohet protokollin që fikson kufirin e shënuar midis dy vendeve. Nuk ka asnjë dyshim që ratifikimi i marrëveshjes së demarkacionit, do të çonte, pashmangshëm, në nënshkrimin e protokollit që do të fiksonte, përfundimisht, mbetjen e

Qafës së Çakorrit dhe Kullës në Mal të Zi. Ky është shqetësimi themelor që lidhet me zbatimin e marrëveshjes së demarkacionit, jo "korrigjimet" që kanë të bëjnë me vendosjen e kufirit në këtë apo atë gur, për të cilat shqetësohen alkimistët. Nga ana tjetër, disa politikanë të lartë, përfshirë presidentin e vendit, Hashim Thaçi. Po kërkojnë me ngulm ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Sipas tyre, Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave, me përjashtim të demarkacionit. Ata theksojnë se ratifikimi i kësaj marrëveshjeje, automatikisht, do të çonte në liberalizimin e vizave dhe në përshpejtimin e proceseve integruuese euroatlantike. Këta politikanë harrojnë një fakt të thjeshtë: nuk janë ata që përcaktojnë, nëse Kosova i ka plotësuar apo jo kriteret për liberalizimin e vizave, por është Brukseli ai që vendosë për këtë çështje. Nëpërmjet përfaqësuesve të vet të lartë, komisionarëve, apo titullarëve të zyrës së BE-së në Prishtinë, ai e ka bërë të qartë se: nga 95 kriteret, Kosova ende nuk i ka plotësuar dy kriteret: demarkacionin dhe luftën kundër korrupsionit; se të dyja ato janë njëlojtë të rëndësishme, pra nuk është demarkacioni kriter i dorës së parë dhe lufta kundër korrupsionit, i dorës së dytë; se po nuk u plotësuan këto dy kriteret, Kosova duhet ta harrojë liberalizimin.

Qëndrimi im rreth marrëveshjes

së demarkacionit me Malin e Zi ka qenë dhe mbetet i qartë dhe i prerë:

Marrëveshja e nënshkruar mes Kosovës dhe Malit të Zi, më 26 gusht 2015, "Mbi Kufirin Shtetëror" është e gabuar dhe në dëm të interesave tona kombëtare e shtetërore. Si e tillë, marrëveshja e demarkacionit duhet të futet sa më shpejt në rendin e ditës të Kuvendit të Kosovës dhe të votohet kundër ratifikimit të saj. Do të kishte qenë në nderin e qeverisë, sikur ajo ta kishte përcjellë atë në parlament me mendimin që të mos ratifikohet. Paanshmëria e qeverisë Haradinaj, në këtë rast, më thelb, është ikje nga përgjegjësia për një çështje madhore si ajo e territorit shtetëror. Kufiri është i shenjtë dhe mbrojtja e tij, një kauzë e drejtë.

Çdo përpjekje për ta shitur ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit nëpërmjet formulave me "letra zotimi" dhe "deklarata të përbashkëta" për korrigjimin, në të ardhmen, të kufirit me Malin e Zi, nuk është gjë tjetër, veç mashtrim për të fshehur humbjen përfundimtare, nga ana e Kosovës, të territorit nga Qafa e Çakorrit deri në Kullë. Kjo humbje do të rëndonte jo vetëm në ndërgjegjen e brezit tonë, por do të ishte një minë me sahat për të ardhmen e marrëdhënieve të Kosovës me Malin e Zi.



Merkeli: Negociata të ashpra për koalicionin

Berlin, 4 shkurt - Kancelarja gjermane Angela Merkel ka thënë se anëtarët e partisë së saj janë përbalhur me negociata të ashpra me Social Demokratët (SPD), derisa janë duke synuar formimin e qeverisë së re. Ende nuk është bërë e ditur se kur mund të mbyllet negociatat. Më shumë se katër muaj pas zgjedhjeve nacionale, ekonomia më e madhe e Evropës vazhdon të mos ketë qeverinë e re. Të dyja kampet dëshirojnë të arrijnë

një marrëveshje deri në fund të së dielës, mirëpo disa politikanë kanë deklaruar se ato mund të vazhdojnë edhe për dy ditë të tjera. "Nuk mund t'iu them se sa mund të zgjasin, ne kemi bërë një punë të mirë dhe, mirëpo ende kemi çështje të rëndësishme që duhet të zgjidhen", ka thënë Merkel para se të nisnin negociatat. Të dyja palët kanë arritur marrëveshje për energji dhe bujqësi të shtunën, mirëpo ende janë duke

diskutuar për kujdesin shëndetësor. Merkel, e cila përmes SPD-së synon ta sigurojë mandatin e katërt në zyrë, ka shtuar se "jam duke shkuar për të diskutuar me qëllim të mira, mirëpo po ashtu pres se do të përballemi me negociata të vështira". Lideri i SPD-së, Martin Schulz, ka thënë se të dyja palët i kanë afër mendimet në disa çështje, mirëpo ende ka diskutime për tema të tjera siç është kujdesi shëndetësor dhe kontratat me afat të përcaktuar.



Irani, Kina e Rusia kundërshtojnë ashpër planin bërthamor të ShBA-së

Plani, i cili parasheh që arsenalin bërthamor amerikan të zëvendësohet me zhvillimin e armëve bërthamore me reze të shkurtër veprimi, i shpallur nga administrata e presidentit amerikan, Donald Trump, është kritikuar ashpër nga Rusia, Irani dhe Kina

TEHERAN, 4 SHKURT - Rusia, Irani dhe Kina kanë kritikuar ashpër planin e ri të politikës së Uashingtonit të publikuar së fundmi për zgjerimin e kapacitetit bërthamor të Shteteve të Bashkuara. Plani, i cili parasheh që arsenalin bërthamor amerikan të zëvendësohet me zhvillimin e armëve bërthamore me reze të shkurtër veprimi, është njoftuar përmes një deklarate nga administrata e presidentit amerikan, Donald Trump më 2 shkurt. Presidenti iranian, Hassan Rohani, e ka akuzuar sot SHBA-në, se "në

mënyrë të paturpshme po e kërcënon Rusinë me armë të re atonike". Duke folur në një fjalim televiziv nga Teherani, Rohani ka thënë se, të njëjtit persona që supozohen se besojnë që përdorimi i armëve është krim kundër njerëzimit, janë duke folur për armë të reja për t'i përdorur kundër rivalëve. Kina të dielën ka kritikuar Qeverinë amerikane për portretizimin e Pekinit si kundërshtar potencial, pasi rishikimi i politikës bërthamore të SHBA-së, ka vlerësuar se Uashingtoni dëshiron të parandalojë Pekinin që gabimisht



të konkludojë se përdorimi i armëve bërthamore, pavarësisht sa i limituar të jetë është i pranueshëm. Ministria e Mbrojtjes e Kinës ka thënë, se aktivitetet e ushtrisë së saj janë për mbrojtje dhe arsenalin bërthamor është në "nivelin mini-

mal", që kërkohet për sigurinë. Përmes një deklarate, kjo ministri ka thënë se shpreson që Shtetet e Bashkuara do të "braktisin mentalitetin e Luftës së Ftohtë". Zyrtarët rusë e kanë cilësuar false, doktrinën bërthamore të SHBA-së, lidhur me supozimet ruse.

Më 3 shkurt, kryetari Komitetit të Këshillit të Federatës Ruse për Mbrojtje dhe Siguri, Viktor Bondarev, ka akuzuar Uashingtonin për kërkimin e një arsyeje për çdo hap të tyre politik, ekonomik apo ushtarak. Kjo është hera e parë prej vitit 2010 që ushtria amerikane ka njoftuar se si i sheh kërcënimet bërthamore në dekadat e ardhshme. Aty thuhet se Rusia duhet ta dijë se do të përballet me "kosto të papërbalueshme", në rast se kërcënon edhe me vetëm sulm të kufizuar bërthamor në Evropë. "Kjo është përgjigje ndaj Rusisë për kapacitetin dhe natyrën e strategjisë dhe doktrinës së tyre", ka thënë, Sekretari i Mbrojtjes, Jim Mattis në raportin 75 faqesh. Në këtë raport gjenden edhe shqetësimet amerikane për Korenë Veriore, Iranin dhe Kinën.

Demokratët e konsiderojnë të gabuar raportin Nunes

UASHINGTON, 4 SHKURT - Një raport i debatueshëm që pretendon se hetuesit e FBI-së kanë abuzuar me detyrën gjatë hetimit të ndërhyrjes së Rusisë në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016, konsiderohet nga demokratët si "jashtëzakonisht i gabuar". Kreu i demokratëve në Komisionin për Gjyqësorin në Dhomën e Përfaqësuesve ka shpërndarë për kolegët e tij një kundërpërgjigje prej gjashtë faqesh, ku raporti Nunes përshkruhet si "qëllimisht çorientues dhe thellësisht i gabuar



në interpretimin e ligjeve". Reagimi i demokratëve erdhi

pasi presidenti Trump deklaroi se ndjehej "plotësisht i shpërguar" pas publikimit të raportit të klasifikuar. Raporti i botuar nga Komisioni për Zbulimin i Dhomës së Përfaqësuesve është "një turp". Kështu shprehet në përgjigje të raportit kreu i demokratëve në Komisionin për Gjyqësorin në Dhomën e Përfaqësuesve, ligjvënësi Jerrold Nadler, i cili ka hartuar një dokument prej gjashtë faqesh. Sipas demokratëve, i ashtuquajti raporti Nunes, i hartuar nga kreu

i Komisionit të Zbulimit, ligjvënësi republikan Devin Nunes, është "qëllimisht çorientues dhe thellësisht i gabuar". Ligjvënësi Nadler mendon se "ligjvënësve republikanë duhet t'u vijë turp". Presidenti Donald Trump, i cili po e kalon fundjavën në kompleksin e tij të golfit në Florida, shkroi në "Twitter" se "ai ndjehej plotësisht i shpërguar", pas botimit të raportit Nunes dhe se megjithatë në ShBA vazhdon pa fund gjuetia e shtrigave. Raporti sekret, i cili u deklaroi

fikua dhe u bë publik të premtën, pretendon se FBI-ja ka abuzuar me autoritetin e saj duke përgjuar të paktën një prej bashkëpunëtorëve të fushatës elektorale Trump. Raporti Nunes thotë se FBI-ja e mbështeti veprimtarinë e saj në një dosje informacioni të krijuar nga Christopher Steele, një ish-agent britanik dhe ekspert për çështjet e Rusisë, i kontraktuar nga fushata e rivalëve Hillary Clinton, dhepërmjet një firme ligjore dhe një kompanie tjetër studimore.

Protesta në Athinë për emrin e Maqedonisë

Athinë, 4 shkurt - Protestuesit në Athinë të dielën kanë mbajtur një tubim masiv për të protestuar kundër një kompromisi të mundshëm grek në një mosmarrëveshje me Maqedoninë fqinje mbi emrin zyrtar të ish-Republikës jugosllave. Qindra autobusë kanë sjellë protestuesit

nga i gjithë vendi në kryeqytetin grek. Shumë të tjerë kanë mbërritur me tragete nga ishujt. Mosmarrëveshja shpërtheu pasi Maqedonia fitoi pavarësinë nga Jugosllavia në vitin 1991. Greqia argumenton se përdorimi i emrit nënkupton pretendime territoriale në krahinën e vet të

Maqedonisë. Zyrtarët në Shkup argumentojnë se vendi i tyre ka qenë i njohur si Maqedoni për një kohë të gjatë. Grindja ka penguar Maqedoninë që të bashkohet me NATO-n, ku Greqia është anëtare. Qeveritë e majta në të dy vendet kanë premtuar të gjejnë një zgjidhje këtë vit.



Këshilli i Pajtimimit në Malishevë 1990

Respekt ndaj heronjve të cilët shtrinë dorën e pajtimimit



Ragip SHALA

Komuna e Malishevës shtrihet në rajonin e Përkorubës, toponim i moçëm shqiptar, që shovinizmi serb pas okupimit 1912 e ndryshoi në "Prekorupa", kurse tani pa të drejtë quhet Llapusha. Ky rajon përfshin territorin nga fshati Duhël, përgjatë rrjedhës së lumit Mirusha, deri në fshatin Kijevë. Përkoruba njihet për kryengritjen e parë në nivel të Kosovës kundër okupimit serb, kryengritja e Banjës (1914), pastaj në mbështetje të Lëvizjes Klandestine (Kaqake) në mes të dy luftërave botërore, NDSH-së, si dhe për zanafillën, rritjen dhe zhvillimin e UÇK-së. Meqë ky rajon banohej kryesisht nga shqiptarët, është quajtur edhe "Shipnia e vogël".

Mbase shaku i "Shipnisë vogël", Përkoruba nuk ishte njësi në vete, e përhershme administrative, prandaj qeverisja komunale bartej herë në Banjë e Kijevë, e herë në Malishevë.

Përkoruba si "Shipni e vogël" gjatë tërë socializmit të Kalimegdanit ka qenë rajoni më i pazhvilluar në RSFJ. Pa as një objekt industrial, pa rrymë, pa rrugë, pa ujë, pa përkudjesje shëndetësore, pa sistem arsimor, kulturor e sportiv. Përkundër izolimit nga "vëllazërim-bashkimi" pushteti shovinist serb ishte i pranishëm në Përkorubë me struktura politike, ushtarake dhe policore.

Në fshatrat Duhël, Banjë, Malishevë dhe Kijevë ndodheshin "stranica" e milicisë që përkudjeseshin për mbarëvajtjen e "vëllazërim-bashkimit".

Kurse Korpusi ushtarakë i APJ-së Nishit stacionohej për muaj të tërë në "Fushë të begut" dhe në Gjakraj të Banjës duke ushtruar terror psikologjik në popullatën e "Shipnisë së vogël". Edhe komisarët politikë të Kuvumovcit gjatë tërë asaj kohe kanë sugjeruar që "uji, zjari dhe hyqmeti s'kanë Aman". Popullata e Përkorubës, nën rrethimin ushtarako-policor, ka qenë tërësisht në getoizim dhe i ngjuar në terrin mesjetar, prandaj kanë dominuar normat e Kanunit. Tërë jeta e përditshme: relacionet familjare, çështjet pronësore, tregtia është rregulluar me norma të Kanunit të Lekë Dukagjinit.

Kontestet pronësore juridike, familjare në mungesë të pushtetit lokal, gjegjësisht gjykatave janë "gjykuar" nga pleqtë e Kanunit. Edhe kur kanë parashtruar çështje juridike pran gjykatave në Prizren, Gjakovë, Pejë, ato qëllimisht janë zvarritur nga komisarët e luftës speciale. Zvarritjet e qëllimita, pastaj "gjykimet" nga pleqtë e kanunit janë ndër shkaqet të konflikteve që

kanë rezultuar me vrasje, rrahje, ngatërresa zinxhirore deri në gjakmarje.

Të ngjuar brenda mureve, shaku i gjakmarjes, familje të tëra kot kanë shpresuar në "mrekulli" të ndonjë "sluzhbeniku" apo "intelektuali" që t'ua hapnin derën. Askush nuk është marrë me konfliktet familjare, me masat parandaluese, me shkaqet, pasojat, në mënyrë që t'i parandalonin vrasjet reciproke. Në fakt disa "intelektuale" shqipfolës janë marrë me "studimin" e fenomenit të gjakmarjes duke mbrojtur në Beograd "disertacione shkencore" mbi gjakmarjet në "Kosmet".

Përkundër asaj mizërie "intelektuale" megjithatë njerëz të mirë "aty-këtu" kanë arritur të pajtonin familje të hasnuara, duke parandaluar gjakmarjet. Por ato pajtime ishin modeste karshi fenomenit gjakmarës jo vetëm në Përkorubë por gjithandej Kosovës. Në prag të shkollimi të RSFJ-së, në fillim të viteve '90-ta, më se dy mijë familje shqiptare kanë jetuar të ngjuar me Besë e pa Besë.

Duke llogaritur mesatarisht nga dhjetë anëtarë për familje, më se 20.000 familjarë kanë jetuar nën psikozën e gjakmarjes dhe po aq në palët e dëmtuara nën presion të "krenarisë kanunore" për të "marrë hakun". Më se 40.000 familjarë shqiptarë kanë qenë "protagonist" të kanunit mesjetar të Lekë Dukagjinit, në socializmin e Lidhjes Komuniste në krye me "shokun" Tito.

Koha e pajtimeve 1990

Në mars 1989 pasi kapitulluan rrogëtarët "e hegemonizmit dhe shovinizmit serb, në krye me "shokun" Azem Vllasi, Kosovën e përfshiu një valë protestash dhe demonstrata popullore për liri, demokraci dhe Republikë. Plumbat e "Zastavës" së Kragujevcit do të vrisnin disa dhjetëra demonstruesë paqësorë anë e mbanë Kosovës. Kurse në nëntor vriten Afrim Zhitia e Fahri Fazliu organizatorë të demonstratave për Kosovën Republikë. Edhe në janar 1990, gjeneralët serbë e përgjakën Kosovën, duke vrarë kryesisht të rinj. RSFJ-ja tani më po "vdiste", Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Makedonia lëviznin drejt pavarësisht, kurse Kosova jo që nuk kishte fituar statusin Republikë, por kishte humbur edhe autonominë e '74-s. Vojslav

Sheshel gjatë një debati në parlamentin e Beogradit, për çështjen e Kosovës, duke ngritur lart revolen pat deklaruar qartë: Kosova i takon atyre që do ta fitojnë me luftë. Në këtë kohë derisa Lidhja Komuniste e Kosovës ishte në procesin e metamorfozës për në LDK, lëvizja klandestine LPK-ja, duke trajtuar rrethanat politike, dhe analizuar format dhe metodat çlirimtare kundër okupimit serb, lëshoi thirrje për pajtim. Në fakt ideja për pajtim, falja e gjaqeve ishte hedhur në qeli të burgjeve serbe nga i madhi Afrim Zhitia dhe "cimarët" e tij.

Në fund të janarit 1990 në Bibliotekën Universitare nga strukturat klandestine të LPK-së janë marrë hapa konkret për finalizimin e thirrjes për pajtim, faljen e gjaqeve dhe ngatërresave. Misionarë për pajtime nga strukturat klandestine të LPK-së do të trokisinin në Institutin Albanologjik, konkretisht në zyrë të Anton Çettës, për ta "cuar në vend" amanetin e Afrim Zhitisë. Koha për pajtime kishte arritur, prandaj Epoka e Pajtimeve tani më po filloonte...

Themelimi i Këshillit të Pajtimimit në Malishevë

A mund të çlirohej Kosova kundër okupimit serb, pa u çliruar nga vetvetja, pa u çliruar më se 40.000 familjarë nga ankthi dhe kthetrat e gjakmarjes.

Prandaj struktura klandestine të LPK-së studentët, udhëtuara nga Prishtina në Malishevë, për të zbatuar thirrjen e LPK-së për pajtim. Në Malishevë akoma figuronin emblemat e RSFJ-së: "Stanica" e milicisë dhe Komiteti komunal i LKJ-së, përkundër procesit të metamorfozës së LKJ-së në LDK. Këshilli i pajtimimit në Malishevë është formuar më 16.02.1990, në objektin e shkollës fillore. Në kuvendin themelues kanë prezantuar 65 pjesëmarrës nga fshatrat e Malishevës. Kuvendi ka zgjedhur Këshillin e Pajtimimit me kryetar Avdyll Berisha, i cili pastaj u vetëlargua.

Këshillin e përbënin këta pajtimtarë: Asllan Kastrati, Avdyll Berisha, Bashkim Krasniqi, Enver Mazreku, Enver Hakdaj, Fatmir Limaj, Feriz Hoti, Maliq Kryeziu, Malsore Zogaj, Hamdi Berisha, Hasime Mazreku, Ibrahim Mazreku, Kurnrije Bashota, Valbona Krasniqi, Gjyle



Krasniqi, Sylejman Mazreku, Shemsi Mazreku, Xhevdet Kastrati, Ramadan Sopaj, Ramë Bashota, Ramadan Mazreku, dhe Ragip Shala. Pastaj na janë bashkangjitur Fetah Bekolli, Januz Mazreku, Nuh Mazreku, Ibrahim Kryeziu, Hamez Kryeziu, Hagi Samadragja, Zyrafete Kuqi, Cen Desku, Sherif Gashi etj. Paralel me Këshillin komunal, ka funksionuar edhe Këshilli lokal në fshatin Banjë të themeluar nga: Fatmir Limaj, Izet Shala, Lulëzim Shurdhajt.

Këshilli i Pajtimimit në Malishevë ka qenë me disa karakteristikat të veçanta:

- Është i Dytë këshill i formuar në nivel të Kosovës (16.Shkurt 1990)
- Gjatë tërë veprimtarisë këshilli ka funksionuar pa kryetar, vetëm me tre koordinator Asllan Kastrati, Shemsi Mazreku, Ragip Shala.
- Të gjitha pajtimet janë realizuar me forca vetanake, pa kërkuar "huva" nga Këshilli Qendrorë në Prishtinë.
- Vullneti, guximi njerëzor i heronjve për ta shtrirë dorën e pajtimimit pa hezituar fare.
- Këshilli i Pajtimimit ka qenë çerdhe për zanafillën e UÇK-së.
- Shumica e pajtimtarëve të Këshillit janë rreshtuar në njësitë të UÇK-së.
- Gjatë luftës së UÇK-së kanë rënë dëshmorë, dy pajtimtarë të Këshillit Ibrahim Mazreku dhe Hamdi Berisha.

Veprimtaria e këshillit në Malishevë është zhvilluar në tri etapa:

- Identifikimi i familjeve fshat për fshat që do u kërkohej pajtimi
- Parapërgatitja: përfshinte vizitat e pajtimtarëve në familje, prezantimi, shpalosja e qëllimit dhe kërkesa për pajtim në emër të aspiratave kombëtare për çlirim.
- Finalizimi: pajtimi, falja e gjaqeve, plagëve, ngatërresave etj. Etapa e parë dhe e dytë kanë përfunduar brenda tri javëve, kurse etapa e tretë gjatë muajit mars dhe prill. Gjatë etapës së tretë pasi ishte muaji i Ramazanit këshilli i nevojitej së paku një klerik fetarë. Gjatë një takimi këshilli është përcaktuar për mulla Xhevat Kryeziu, meqë ishte hoxhë më i ri nga mosha, dhe më i moderuar. Këshillin e pajtimimit në Malishevë e

përbënin kryesisht rinia shkollorë dhe universitare, profesor, asistent, mjekë, bujq etj. Pastaj na janë bashkangjitur edhe heronjtë e pajtimeve. Për etapën e identifikimit dhe parapërgatitjes, pajtimtarët janë ndarë në grupe pune, duke përkshuar fshatrat kryesisht në këmbë.

Kurse në etapën e finalizimit - pajtimin, kanë marrë pjesë pothuajse tërë këshilli i pajtimimit. Meqë në disa raste ndërldheshin pajtimet me komunat fqinje, prandaj këshilli i Malishevës ka bashkëpunuar me këshilla të Suharekës, Prizrenit, Klinës, kurse këtë të fundit, këshilli i Malishevës ka dhënë ndihmës edhe në themelimin.

Në një pajtim të ndërlikuar, që gjeografikisht shtrihet në territor të Malishevës dhe Suharekës ndihmës të pakursyer na kanë ofruar pajtimtarët prof. Ramadan Shala dhe doajeni i çështjes kombëtare Afrim Morina.

Meqë e kemi hasur kudo gatishmërinë e heronjve të pajtimimit, për "t'u marrë ngryk", prandaj këshilli i pajtimimit ka arritur që për një kohë të shkurtër t'i pajtoj të gjitha gjaqet, plagët dhe ngatërresat, para se "të falej" Bajrami në tubimin e Bubavecit. Pasi veprimtaria e këshillit të Malishevës, pothuajse fare nuk pasqyrohej në mjetet e komunikimit masiv, sidomos, tubimi i Bubavecit, prandaj ka dërguar mesazh pajtimi gjithandej Kosovës. Duke ju falënderuar heronjtë të pajtimimit, të cilët falnin gjakun e babait, axhës, vëllait, djalit, këshilli i pajtimimit në Malishevë arriti t'i pajtoj: 45 gjaqe, 12 plagë dhe 60 ngatërresa.

Vjetërsia e gjaqeve mesatarisht arinte 10 vjet, plagëve 6 vjet dhe ngatërresave 2 vjet. Hyrja në oda burrash, sidomos e gjinisë femërore, forma e veprimtimit theu kodin e kanunit të Lekë Dukagjinit, që s'kishte ndodhur as njëherë më parë.

Vullneti për pajtime ishte një sinjal se populli vërtet e donte lirinë, prandaj i falën gjaqet, plagët dhe ngatërresat.

Realizimi i thirrjes për pajtime, ishte çlirim ndaj vetvetes, prandaj Lëvizjen Klandestine do ta obligonte që me forma politike dhe ushtarake të angazhohej dhe për çlirim nga okupimi shekullor serb.

Arbneshi i Zarës që vërtetoi autoktoninë e ilirëve dhe shqiptarëve

Në vitin 2015 u nda nga jeta albanologu i shquar Aleksandër Stipčević. Ai ishte arkeolog, bibliograf, etnograf, ishte shkencëtar dhe personalitet i shquar, që me përkushtim dhe argument shkencor mbrojti autoktoninë e ilirëve e të shqiptarëve dhe vendin e rëndësishëm të tyre në historinë e Ballkanit Perëndimor.

Me veprimtarinë shkencore të A. Stipčevićit jam njohur 50 vite më parë, kur pata rastin të marr librin "Ilirët", Prishtinë 1967, të përkthyer nga italishtja nga prof. Z. Mirdita.

I nxitur nga interesi e vlera shkencore e librit, edhe për lexuesin në Shqipëri, i cili në atë kohë, kishte mundësi shumë të kufizuara për t'u njohur me literaturën e huaj, botova një recension, ku ndër të tjera kam shkruar: "Pas veprës së Karl Paçit 'Ilirët', përkthyer e botuar shqip në Tiranë në vitin 1923, vepra e A. Stipčevićit shënoi një sukses të ri në fushën e ilirologjisë". (Studime historike 1968, 4, f. 201-206).

Në Kuvendin e Dytë të Studimeve Ilire, që zhvilloi punimet në vitin 1985 në Tiranë, ishte i ftuar edhe A. Stipčević, kështu u njohëm e vazhduam miqësinë, bashkëpunimin e shkëmbimit të literaturës deri në fund të jetës së tij.

Pjesëmarrja e Stipčevićit në këtë Kuvend dhe njohja direkt me rezultatet e kërkimeve arkeologjike në Shqipëri e zgjeruan në mënyrë cilësore dijen për historinë dhe kulturën e Ilirisë së Jugut, për vendin dhe rolin që ata kanë pasur në historinë antike të Ballkanit Perëndimor.

Të gjitha këto A. Stipčević i pasqyrooi në ribotimin e zgjeruar e shumë më të plotë të veprës së tij për ilirët, të botuar më parë në Prishtinë e në vitin 2002, në Tiranë nga shtypshkronja "Toena".

Libri është zgjeruar në mënyrë cilësore me pjesët "Simbolet e kultit të ilirët", "Struktura e simbolizmit ilir, prejardhja dhe zhvillimi

mi i simbolizmit ilir dhe mbeturina e simbolizmit ilir në kulturën e mëvonshme në Ballkan".


Veprën e prof. A. Stipčević e karakterizon përpjekja e vazhdueshme për të plotësuar, saktësuar e thelluar çështjet që trajton në vazhdimësi, siç është edhe qëndrimi i tij për çështjen e origjinës së ilirëve.

Kështu, në intervistën e vitit 1985 ("Bota e re", Prishtinë), ai në mënyrë thelbësore ka shprehur qëndrimin kur shkruan "Çdo tregim për Ballkanin fillon me ilirët: Të gjitha ato fise, apo, siç i quajmë, popuj, të cilët kanë jetuar në pjesën perëndimore të Ballkanit e që i quajmë ilirë, sheshazi shihet se, pavarësisht nga dallimet, kanë pasur mjaft elementë të përbashkëta, në bazë të cilave mund të flitet për ilirët si një "lidhje", si tërësi fisesh të ndryshme me përbashkësi të mjaftueshme.

Qëndrimet e pikëpamjet e prof. A. Stipčevićit janë të qarta edhe për banorët e Ballkanit Perëndimor në periudhën e vonë antike. Me rëndësi është konstatimi i tij, se me gjithë depërtimin e kulturës e qytetërimit romak, ilirët vazhduan të flisnin gjuhën e tyre, të adhuronin perënditë e tyre dhe të vdekurit i varrosnin në mënyrën e tyre tradicionale, i veshin kostumet e tyre popullore dhe përcjellin rendin shoqëror politik të organizimit të tyre fisnor.

Nga këto pohime del qartë qëndrimi i tij se nuk flitet për romanizim të ilirëve dhe as për asimilim e zhdukje të tyre, gjë që dëshmohej nga të dhënat që sjell autori për vendbanimet, kultet, për disa perandorë romakë me origjinë ilire dhe kontributin e tyre në jetën politike e kulturore, në ekonominë etj.

Në vazhdim të kësaj pikëpamjeje që A. Stipčević u bën mbeturinave ilire në Ballkan çon në vazhdimin logjik të banimit të trojeve ilire nga e njëjta popullsi. Depërtimi i kulturës dhe qytetërimit romak nuk ndryshoi përbërjen etnike të



banorëve, ata – shkruan A. Stipčević – vazhdojnë të flasin gjuhën e tyre, adhurojnë perënditë e tyre; të vdekurit i varrosin në mënyrë tradicionale, punojnë tokën ashtu siç e kanë punuar me shekuj të parët e tyre, i veshin kostumet e tyre popullore dhe e përcjellin rendin shoqëror e politik të organizimit të tyre fisnor, që vetëm në rast nevojë i adoptojnë strukturës së administratës romake. Karakteri enciklopedik i veprës së prof. A. Stipčević dëshmohej edhe në kreun ku trajton jetën e përditshme dhe doket tek ilirët. Autori ka shfrytëzuar të dhënat e fragmentuara që gjenden në veprat e autorëve antikë si edhe një mori faktesh që vijnë nga gërmimet arkeologjike. Duke bashkërenduar të dhënat e shkruara me ato të kulturës materiale, ka mundur të rindërtojë qoftë edhe në formë hamendësimi, disa nga aspektet e jetës së ilirëve si, armatimet e një luftëtari ilir, stollitë e gruas ilire, elemente të veshjes. Autori ka shfrytëzuar të dhëna, ndonëse të kufizuara, për të ndriçuar aspekte të jetës së ilirëve si për tatuazhin, higijenën, sëmundjet, ilaçet që përdornin

ilirët etj.

Duke grumbulluar copëza nga burimet e shkruara e nga gjetja e objekteve të kulturës materiale flet për bujqësinë, blegtorinë, gjuhën, peshkatarinë, xehtarinë, për minierat e krypës, prodhimin e qelqit, rrugët tregtare, monedhat etj. Qëmtimi, grumbullimi dhe sistemimi i të dhënave qoftë edhe të fragmentuara, ashtu siç vijnë nga lashtësia, mundësojnë rindërtimin në formë hipoteke të aspekteve të jetës së përditshme të stërgjyshërve tanë.

Një vlerë të tillë ka trajtesa për jetën shpirtërore, për religjionin, totemizmin, artin figurativ, doket mortore, muzikën, vallet, shkrimin e gjuhën e ilirëve.

Veprimtaria shkencore e A. Stipčevićit karakterizohet nga përditësimi e korrektesa shkencore në plotësimin e veprës me të dhënat e reja, si edhe me rishikimi e pikëpamjeve në dritën e zbulimeve të reja arkeologjike.

Kjo dëshmohej më së miri në botimin në shqip të veprës "ILIRËT, historia, jeta, kultura, simbolet e kultit", Tiranë 2002, ku janë përshirë tërësisht pjesë të reja si "Simbolet e kultit të ilirët".


Në këtë shtojcë prej 196 f., e cila mund të ishte edhe një libër më vete, si nga trajtesa e veçantë dhe e detajuar e kulteve të ilirëve, e simbolizmi religjioz, ashtu edhe nga vëllimi është një ndihmesë e re cilësore për njohjen e jetës shpirtërore të banorëve të tejlashtë të vendit tonë.

Karakterit enciklopedik i veprimtarisë së A. Stipčevićit provohet katërçipërisht edhe në drejtimin shkencor të Bibliotekës së Akademisë së Shkencave të Kroacisë, ku ka dhënë një ndihmesë të shquar në punimin metodik e shkencor të librit. Ai është autor i bibliografisë analitike të ish-Jugosllavisë dhe autor i veprës "Povijesknigi" (Historia e librit), Zagreb 1985, f.560, shoqëruar me shumë ilustrime, veprë e përkthyer në shqip e botuar në Prishtinë 1988 dhe ribotuar në Tiranë në vitin 2000. Libri karakterizohet nga një informacion i hollësishëm e i dokumentuar, i përhapjes së shkrimit dhe librit në botë, duke iu përmbajtur karakterit kronologjik e gjeografik të përhapjes së tij.

Rrëfimin për historinë e librit, autori e nis me pllakat prej balte të shkruara, të gjetura 4500 vjet më parë në Mesopotaminë e lashtë, e në vijim me shkrimin në Lindjen e Mesme e të Largët, me librin në botën greko-romake, në Mesjetën evropiane, në Perandorinë Bizantine, në botën arabe, në Lindjen e Largët në Mesjetë, në civilizimet parakolumbiane të Amerikës, në periudhën e Rilindjes Evropiane, e deri tek libri e bibliotekat në shek. XX. Vepra "Historia e librit" e Stipčevićit është realizimi enciklopedik më i plotë që njohim për historinë e librit, e botuar deri më sot.

Aleksandër Stipčević ishte shkencëtar dhe personalitet i shquar shoqëror, që me veprën e tij shkencore enciklopedike hyn në radhën e albanologëve më në zë të dekadave të fundit.

(Gazeta Shqiptare Online)



Rita Ora me dy tatuazhe të reja




Rita Ora është një ndër këngëtares më të suksesshme shqiptare në rrafshin ndërkombëtar. Këngëtarja është duke punuar në këngë të reja që do t'i publikojë gjatë muajve në vijim. Por, së fundi, Rita Ora, që njihet për

shumë vizatime në trup, i ka shtuar edhe një të tillë. Kështu së paku ka bërë me dije këngëtarja përmes llogarisë personale në "Instagram" teksa ka publikuar edhe imazhe të tatuazheve të reja. Ajo ka vendosur një tatuazh në kokë dhe një në dorë.

Modeli Egzon Berisha, me suksese të reja në Turqi dhe Tajlandë



Egzon Berisha po vazhdon me suksese në rrugën e modelimit, duke u shndërruar në njërin ndër më të kërkuarit edhe përtej kufijve tanë. Bukuroshi prishtinas deri më tani është paraqitur në një numër të madh të pasarelave, duke qenë fytyrë e markave të ndryshme shqiptare të veshjeve. Ai së fundmi është duke bashkëpunuar me kompaninë e njohur të modelimit me seli në Stamboll të Turqisë "Ice model". Pas shtetit turk, Berisha do të udhëtojë për në kontinentin aziatik, ku do të jetë pjesë e pasarelave në Bangkok të Tajlandës, ku pritet të jetë pjesë edhe e shumë projekteve të modës.



Jennifer Lopezi nuk di të plaket

Jennifer Lopezi ka pozuar me veshjet e markës "Guess" duke treguar se ka gjetur sekretin e rinisë së përgjeshme. 48-vjeçarja

shihet e veshur me rroba të ngushta, që i tregojnë format trupore fantastike që u rezistojnë viteve.

Michael Buble dhe Luisana Lopilato pritet të bëhen prindër për herë të tretë



Michael Buble dhe bashkëshortja Luisana Lopilato po presin fëmijën e tyre të tretë, shkruan "US Weekly". Sipas raportimeve të medieve,

aktorja 30-vjeçare është në muajin e dytë të shtatzënisë. Lajm i lumtur vjen pas një viti që djali i tyre i madh, Noah, fitoi luftën me sëmundjen e rëndë të kancerit.

Intervistë për punë? Gabimet që duhen shmangur në takimin e parë



Është e kotë ta mohojmë sepse veshja e duhur ndihmon. Kur shkojmë për intervistë pune gjithmonë jemi të emocionuar dhe shpesh përshtypja e parë është ajo që mbetet më e gjallë në ata që na intervistojnë. Duke e ditur se keni pamjen më të përshtatshme mund të jetë një lehtësim i madh. Pra, ndaloni ankthin dhe merrni disa këshilla për të shmangur gabimet: thjesht gjeni kombinimin e duhur të formalitetit dhe origjinalitetit, për të qenë sa më elegante dhe që të bini në sy.

Le të fillojmë nga e para: Rregulli dhe pastërtia janë minimalet për t'u paraqitur në një intervistë pune. Pra, le të fillojmë nga flokët tona, të cilat duhet të jenë të pastra dhe të rregulluara. I lani me kujdes flokët në mënyrë që të shkëlqejnë. Mos shkoni te parukierja. Më mirë të japësh një përshtypje të mirëfilltë dhe kjo na reflekton më mirë, një hairstyle

shumë i përpunuar do të tingëlonte paksa e tepruar. Shkoni me flokë të lirshëm dhe të butë ose një bisht të thjeshtë, dhe që janë të përshtatshme për moshën tuaj.

Fjalëkalimi: Mirësjellje! Shmangia e ekzagjerimit duket shumë agresive ose në modë është një rregull i mirë, gjithashtu sepse nuk e dimë se kë do të kemi përpara se të arrijmë në vendin e takimit. Ne nuk e dimë kontekstin, as personin që do të na intervistojë: është më mirë të qëndrojmë në një veshje formale, por jo rigorozë, elegante, apo të çuditshme. Pra mos e ekzagjeroni shumë.

Kodi i veshjes: Mund të jeni formal dhe në të njëjtën kohë origjinal pa tejkaluar, por është absolutisht e mundur që të kuroni pamjen tuaj. Nëse veshjet tona janë të pajisura mirë me xhinse dhe me bluza me ngjyra të ndezura, është më mirë të braktisësh

gjithçka dhe të përfitosh nga shitjet për të blerë një veshje të thjeshtë të rrabave të zeza ose gri, në të cilën mund të kombinosh disa nga bizhuteritë e thjeshta që nuk janë shumë të dukshme; nëse kemi këmisha të bardha, po, madje edhe xhinse, për aq kohë sa është e zbutur nga një triko e butë dhe ndoshta thembra nuk është shumë e lartë dhe jo veçanërisht e dukshme. Xhaketa ka shënuar një ritëm të vogël, jo ato të viteve '80, kështu që më mirë të zgjedhësh ngjyrën e 'kardigamit' të madh dhe neutral ose të zi, një klasik që kurrë nuk gërmon.

Shikoni poshtë: Këpuçët gjithmonë janë shumë të rëndësishme dhe, edhe nëse veshjet tona janë të mbushura me këpuçë të të gjitha llojeve dhe formave, ne gjithmonë duket të humbasim të drejtën për rastin. Taka është gjithmonë shumë joshëse, por ekzagjerimi nuk është i këshillueshëm. Edhe në

këtë rast, fiton thjeshtësia: u thoni po çizmeve të zeza, dhe sidomos nëse janë pa taka, ndoshta pak dhe me dantella: sepse gjithnjë feminiteti vlerësohet.

Ja cili është truku: Për shumë prej nesh, make-up është e rëndësishme për t'u ndjerë të sigurt me pamjen tuaj. Të jesh e bukur dhe të përmirësosh ose të theksosh pikat e forta (pamja, goja, mishi) është absolutisht e ligjshme, ndryshe është të ekzagjerohet. Nëse përqendrohemi tek sytë, duhet të shmangim buzëkuqët shumë të ndritshëm dhe preferojmë ngjyrat neutrale ose nud; nëse, nga ana tjetër, buzët janë kartela jonë e biznesit, ne lehtësojmë qepallat dhe ndoshta kufizohemi tek peneli dhe bojë për vetulla.

Duat në vend: Kujdesi për duart është i rëndësishëm për të gjithë, burra dhe gra. Në të vërtetë,

duart e pastra dhe të buta janë një shenjë e higjienës dhe pastërtisë së mirë personale. Edhe thonjtë duhet të jenë në vendin e duhur: po për të pastruar gozhdët me ngjyra të buta, definitivisht jo për manikura shumë agresive ose për thonjtë me gjatësi të ekzagjeruar. Pra duhet të kemi një imazh sa më të mirë si kandidatë të shkëlqyer për një vend pune.

Edhe jo: Gabimet sensacionale që duhet të shmangen janë: çamçakëzat gjatë intervistës, shikimi në telefon ose - më keq - përgjigjja e një thirrjeje që është asgjë, por urgjente, duke mbajtur qëndrime të pahijshme ose shumë provokative me intervistuesin. Le të kujtojmë se nuk jemi në kafe me një mik, kështu që qëndrimi miqësor por i respektueshëm është gjithnjë i domosdoshëm... aq më tepër në takimin e parë!

(gazeta-Shqip.com)

E jashtëzakonshme

Familja indoneziane mban krokodilin në shtëpi

Një familje indoneziane nuk ka zgjedhur një mace apo qen si kafshë shtëpiake, por një krokodil gati dy metra të gjatë. Muhamad Iwan e konsideron krokodilin pjesë të familjes dhe kujdeset për të si të ishte një kafshë normale duke e larë e duke luajtur me të. Ai krokodilin e ushqen me dy kilogramë peshk në ditë, si dhe i ka krijuar një kënd në shtëpi ku vijnë njerëz të ndryshëm për ta parë e bërë fotografi.



FOTO E DITES



Një burrë peshkon në rrethin bregdetar të Alimos në Athinë. / AP/

E rrallë

Tani lopët do të njihen nga fytyra për qumështin dhe ushqimin

Shumë shpejt lopët mund të kenë një pasaportë biometrike me fytyrën e tyre dhe synimi nuk është udhëtimi i tyre jashtë shtetit, por shëndeti. Një kompani irlandeze ka nisur një proces për njohjen e "fytyrës" për lopët, duke realizuar një investim të fshehtë nga korporatat më të mëdha nga ShBA-ja si Cargill.



BARSOLETA E DITËS



Gjyshi: Ju të rinjtë po rrinë tërë ditën në telefon.
Kurrgjë puna juaj.
Nipi: E pse kishe?
Gjyshi: Sepse jeni bërë të varur prej teknologjisë.
